



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosova

ZYRA RREGULLATORE PËR UJËSJELLËS DHE KANALIZIM  
REGULATORNI URED ZA VODU I KANALIZACIJU  
WATER AND WASTEWATER REGULATORY OFFICE



# RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS PËR OFRUESIT E SHËRBIMEVE TË UJIT NË KOSOVË NË 2014

Raporti për performancën e kompanive të licensuara të furnizimit me ujë, shërbimeve të ujërave të zeza dhe furnizimit me shumicë me ujë të patrajtuar

## Zyra Rregullatore për Ujësjetës dhe Kanalizim

### Vizioni

“Shërbime cilësore, të sigurta dhe efikente të ujësjetës dhe ujërave të zeza për të gjithë konsumatorët në Kosovë”

### Misioni

“Rregullimi i shërbimeve të ujit në mënyrë efektive dhe transparente në pajtim me praktikën e mirë Evropiane të cilat sigurojnë që ofruesit e shërbimeve të ujësjetës dhe kanalizimit të japin shërbime kualitative, të qëndrueshme dhe me çmime të përballueshme në tërë Kosovën, duke pasur parasysh ruajtjen e mjedisit dhe mbrojtjen e shëndetit Publik”.

## PËRMBAJTJA

Parathënie	6
Roli dhe përgjegjësitë e ZRRUK	8
1 Hyrje	9
2 Zhvillimet në sektor	10
Pjesa A	
3 Performanca e Kompanive Rajonale të Ujësjesit-Kanalizimit	
3.1 Furnizimi me ujë	13
3.2 Shërbimet për ujëra të zeza	27
3.3 Performanca financiare e KRU	34
3.4 Performanca e përgjithshme e KRU	36
Pjesa B	
4 Performanca e sektorit të shërbimeve të Ujësjesit-Kanalizimit	
4.1 Uji i prodhuar, shitjet dhe UPF	44
4.2 Mbulueshmëria me shërbime	45
4.3 Të ardhurat e planifikuara, qarkullimi dhe paraja e gatshme e arkëtuar	46
4.4 Shpenzimet kapitale për shërbime të furnizimit me ujë dhe ujëra të zeza	47
Pjesa C	
5 Performanca e furnizuesit të ujit me shumicë (NH Iber-Iepenci)	49
Pjesa D	
6 Aktivitetet e KKK	51
7 Sfidat për të ardhmën	53
SHTOJCA 1 Të dhënat e detajuara të performancës	55
SHTOJCA 2 Definicionet dhe arsyeshmëria	70
SHTOJCA 3 Pasqyrat përmbledhëse e të ardhurave	78
SHTOJCA 4 Pasqyrat tarifore(2015-2017)	82
SHTOJCA 5 Përmbledhje treguesish të performancës-2014	83
SHTOJCA 6 Të dhëna statistikore-2014	84
SHTOJCA 7 Detajet kontaktuese	85
SHTOJCA 8 Zonat e shërbimit të KRU	87

## AKRONIMET DHE SHKURTESAT

ASK	Agjensioni i Statistikave të Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
BD	Bordi i Drejtorëve
BB	Banka Botrore
BPRR	Biznis Planet Rregullatore
KRU	Kompania Rajonale e Ujësllësit
PR	Kompania Rajonale e Ujësllësit, 'Prishtina' (Prishtinë)
PZ	Kompania Rajonale e Ujësllësit 'Hidroregjioni Jugor' (Prizren)
PE	Kompania Rajonale e Ujësllësit 'Hidrodrini' (Pejë)
MIT	Kompania Rajonale e Ujësllësit 'Mitrovica' (Mitrovicë)
GJA	Kompania Rajonale e Ujësllësit 'Radoniqi' (Gjakovë)
FE	Kompania Rajonale e Ujësllësit 'Bifurkacioni' (Ferizaj)
GJI	Kompania Rajonale e Ujësllësit 'Hidromorava' (Gjilan)
IKSHPK	Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik të Kosovës
QU	Qendra e Ujit (IKSHPK)
IL	NH 'Ibër Lepenci'
IAWD	Shoqata Ndërkombëtare e Ujit për Vendet e Danubit
NJPM-NP	Njësia për Politika e Monitorim të Ndërmarrjeve Publike
KKK	Komisionet Këshilluese të Konsumatorëve
SCO	Zyra Zvicerane për Bashkpunim në Kosovë
MAPH	Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor
NP	Ndërmarrje Publike
KNMU	Këshilli Ndër Ministror për Ujërat
TKP	Treguesit Kyç të Performancës
UPF	Uji i Pa-Faturuar
ZRRUK	Zyra Rregullatore për Ujësllës dhe Kanalizim

## PARATHËNIE

Në përputhje me mandatin e tij për të informuar publikun mbi çështjet e lidhura me punën e Ofruesve të shërbimeve të ujit, ZRRUK publikon raportin vjetor të performancës të nëntin me radhë në të cilin pasqyrohet, ecuria dhe gjendja e performancës individuale të KRU si dhe sektorit në përgjithësi.

Përgjegjësia e sigurimit të shërbimeve me ujë, me të vërtetë është një punë e rëndësishme, pasi ajo ofron mbështetjen për mirëqenien e përgjithshme për popullatën e vendit. Kjo është një detyrë jo e lehtë dhe e ballafaquar me shumë sfida.

Edhe ky raport i performancës për vitin 2014. Pra, ka identifikuar pikat më të dobëta në fusha të veçanta dhe ato me potencial më të madh për përmirësim. Gjithnjë duke synuar motivimin dhe përkushtimin e ofruesve të shërbimeve për të përmirësuar performancën e tyre si dhe duke nxjerrë në pah fushat që kërkojnë, ndoshta ndërhyrje edhe të Qeverisë së Kosovës me qëllim të përmirësimit të sektorit të shërbimeve të ujit.

Efienca e faturimit dhe arkëtimit, krahas nivelit të lartë të ujit të pafaturuar, mbeten edhe më tej problemet më të mëdha me të cilat ballafaqohen, pa përjashtuar të gjithë, Ofruesit e shërbimeve në vende. Aktualisht ¼ e borxheve për shërbimet e ofruar nuk mund të mbledhen, poashtu edhe mbi gjysma e prodhimit të ujit, humbet dhe nuk sjelle të ardhura për kompanitë. Menaxhmenti i ofruesve të shërbimeve, duhet këto dy çështje ti mbaje prioritet duke angazhuar edhe më tej kapacitetet e tyre menaxheriale si dhe duke vepruar në mënyrë të planifikuar dhe strategjike.

Rrethe 76 mili.m<sup>3</sup> është vlera sasiore e UPF i cili është trajtuar dhe distribuar tek konsumatorët dhe i cili nuk sjellë të ardhur për kompanitë, perkundrazi, ka krijuar shpenzime dhe munges të furnizimit të rregullt me ujë. Për ta parë me çartë dimenzionin e kesaj sfide në konteks vendor është se sasia prej 76 mil.m<sup>3</sup> i UPF, është mbi sasin e rezervave vjetore që gjendet në tri akumulacionet, s'bashku (Batllava, Badovci dhe Perlepnica) që kanë në dispozicion KRU (Prishtina dhe Hidromorava).

Ofruesit e shërbimeve po ashtu i inkurajojmë që të përdorin më me efikasitet mekanizmat ligjore të cilët i kanë në disponim për të shënuar eficiency më të madhe në këtë drejtim. Nga ana tjetër ne i bejëm, thirrje të gjithë konsumatorëve në vend të jenë të përgjegjshëm, se duhet paguar për shërbimet dhe ujin duhet përdorur në mënyrë racionale. Jo vetëm për shkak se shërbimet që ju ofrohen, kanë një kosto të madhe por edhe për faktin se ende ka deficite të konsiderueshëm në përmbushjen e kërkesave për furnizim me ujë (mbi 40% e qytetarëve nuk kanë furnizim të rregullt). **Ne jemi të bindur se dështim i vazhdueshëm për të paguar dhe keqpërdorimi i ujit të pijshëm, është një recetë e sigurt për mungesë në ofrimin e shërbimeve të qëndrueshëm.**

Menaxhmenti i ofruesve të shërbimeve të ujit, duhet të kuptojnë se ata janë në drejtimin e një biznesi si edhe bizneset e tjera dhe kështu duhet të jenë të lirë në menaxhimin e kostove, reduktimin e ujit të pafaturuar, matjen e ujit të konsumuar. P.sh- **"Nëse uji i konsumuar nga konsumatorët nuk ju matet? Si do të jetë e mundur për të menaxhuar atë!**, I gjithë stafi i kompanive të ujit duhet të kenë orientim. Pra, ofrimin e shërbimeve me kosto të ndërgjegjshme dhe të mbledhin sa më shumë nga borgjet e konsumatorëve për shërbimet e faturuar të ujit.

Përderisa në vitet e fundit kemi, përshpejtim në zgjerimin e mbulushmëris me shërbime të furnizimit me ujë dhe shërbime të kanalizimit nga Ofruesit publik, ato ende janë të ulëta (84%, furnizim me ujë, respektivisht 62%, shërbime të kanalizimit). Trajtimi i ujërave të zeza, po thuasje nuk ka levizuar fare, është faktë i pa mohueshëm se mungesa e trajtimit të ujërave të zeza, mund të ketë pasoja serioze, sidomos në shëndetin publik. Në këtë drejtim ZRRUK, kujton nevojën që të gjitha palët e interesuara të luajnë rolin e tyre për të përmirësuar ofrimin e shërbimeve të trajtimit të ujërave të zeza, meqense kjo detyrë e madhe, qëndron mbi të gjitha palët e interesit në sektorin e ujit.

Pritja nga publiku i gjerë në lidhje me cilësinë e furnizimit me ujë dhe kanalizimet, ende është nën standardin e pritur, fakt i cili dëshkohet edhe nga numri në rritje i ankesave nga konsumatorë, drejtuar Ofruesve të shërbimeve dhe Rregullatorit(KKK).

Sfidën e madhe e të qenit në gjendje për të financuar, aktivitetet operacionale nga burimet e veta pothuajse e kanë kapërcyer shumica e KRU. Pra, ato janë aktualisht në gjendje për të plotësuar aktivitetet e përditëshme (energjinë, personelin, materialet kimike dhe shpenzimet e tjera të mirëmbajtjes) nga mbledhja e faturave të ujit. Tani duhet punuar intenzivisht në financimin për infrastrukturën, meqenëse periudha e gjatë e mungesës së investimeve të duhura në këtë drejtim do të kërkojë në vazhdimësi shuma të konsiderueshme të mjeteve monetare nga burimet vetanake por edhe të jashtme, siq është Qeveria apo partnerët ndërkombëtarë bashkëpunues. Norma e defekteve në nivel sektori në rrjetin kryesor të furnizimit me ujësjellës është raportuar të jetë në 279(defekte për 100 km), me një trendë gradual të përmirësimit, megjithëse ende largë normave dhe standardevë të vendeve Europiane. Kryesisht i ndikuar nga një sërë faktorësh, përfshirë: llojin(materialin) e gypave, moshën e rrjetës, standardin e mirëmbajtjes së kryerë nga ofruesi i shërbimit, etje.

Tani më ka përfunduar procesit tarifar 3 vjeçar 2012-2014, Biznes planet e aprovuara nga Rregullatori, kanë qenë një lloj kontrate e nënkuptuar në bazë të të cilave rregullatori ishte, pajtuar me ato tarifa të cilat, janë bazuar në detyrimin e marrë nga KRU. Ne kujtojmë se objektivat kanë qenë sfiduese por realisht të arritshme. Ne me keqë ardhje tani mundë të konstatojm se shumica e objektivave nuk janë arritur. Ne kemi shprehur vazhdimisht mospajtimin tonë, sidomos me mos përmbushjen e nivelit të investimeve infrastrukturore dhe reduktimin e shpenzimeve operative, (shpenzimeve të pa justifikueshme), meqenëse jemi të bindur se KRU, është dashur të përpiqen me tepër për të përmbushur ato.

Viti 2014, po ashtu ka qenë viti i shqyrtimit të kërkesave tarifore për periudhën e ardhëshme trevjeqare(2015-2017), për ofruesit e shërbimeve publike të furnizimit me ujë me pakicë dhe shumicë si dhe për shërbimet e trajtimt të grumbullimit të ujërave të zeza. Pase një periudhe të konsultimit dhe debatimit me ofruesit e shërbimeve dhe konsumatorët, tarifat e reja janë aprovuar dhe janë vendosur në zbatim që nga fillimi i vitit 2015. Fokusi i Rregullatorit ka qenë, balancimi i interesave të konsumatorëve për marrjen e shërbimeve të ujit, me nevojën për të ruajtur integritetin financiar të KRU-ve. Gjithenjë duke marrë parasysh aftësinë e konsumatorëve për të paguar faturat e tyre. Tarifat e reja kanë paraparë, rritje simbolike përgjate tri vitet për konsumatorët shtëpiak, perderisa për konsumatorët jo-shtëpiakë në përputhje me politikat rregullatore do të kenë ulje graduale.

Publikim i ketij raporti e gjenë ZRRUK, pa stafin e lartë menagjues(Drejtori dhe Zv. Drejtori), të cilëve ju ka perfunduar mandati pesë vjeçar, në prill të vitit 2015, ne i falenderojm për punën dhe kontributin e dhënë për zhvillimin e Rregullatorit dhe sektorit të shërbimeve të ujit në Kosovë. Ne shpresojm që Kuvendi i Kosovës së shpejti do të marr vendim për emrimin e Drejtorit dhe Z.v. Drejtorit të ZRRUK. si dy pozita kyq të ngarkuar me përgjegjesin ligjore për të marrë vendime Rregullatore.

S' fundi, ne shprehim mirënjohje dhe konsideratën, për stafin e KRU dhe ZRRUK, për angazhimin dhe bashkpunimin, gjatë procesit të raportimit dhe përpunimit të dhënave, për analizën, diskutimin dhe komentet e dhenë në këtë raport.

## ROLI DHE PËRGJEGJËSITË E ZRRUK

Si rregullator ekonomik i sektorit të shërbimeve të ujit në Kosovë, roli i ZRRUK është për të ndihmuar zhvillimin e ofruesve të shërbimeve dhe sektorin në përgjithësi dhe njëkohësisht duke mbrojtur interesin e konsumatorëve. Për me teper roli i Rregullatorit në sektorin e furnizimit me ujë dhe shërbimeve të ujërave të zeza është për të siguruar se ofruesit publik të shërbimeve, nuk keqpërdorin pozitat e tyre monopoliste, por të ofrojnë një standard të arsyeshëm të shërbimit me një çmim të drejtë dhe se të drejtat dhe detyrimet e tyre të ndërsjellta, janë të balancuara në mënyrë të drejtë. Meqenëse natyra e këtij shërbimi është e karakterit të monopolit natyror dhe faktit se ka mungesë të nxitjes për të kërkuar efikasitet dhe efektivitet më të madhë, ka një prevalencë në rritje të rreziqeve për përdoruesit që ata të mos marrin një shërbim të dëshiruar. ZRRUK ka promovuar nxitjen e konkurrencën efektive duke siguruar që funksionet e kompanive të ujit, janë mbartur siç duhet dhe se ata janë në gjendje për të financuar funksionet e tyre, në veçanti si dhe duke siguruar një kthim të arsyeshëm për kapitalin e tyre.

Në mënyrë më specifike përgjegjësitë kryesore të ZRRUK mund të specifikohen si në vijim:

- Përcaktimi i tarifave në nivele të mjaftueshme për ofruesit e shërbimeve për të financuar aktivitetet e tyre në përputhje me standardet e obligueshme të shërbimit dhe në nivel të pranueshëm të pritjeve për shërbime;
- Liçensimi i ofruesve të shërbimeve të furnizimit me ujë, si dhe sigurimi që ofruesit e shërbimeve përmbushin obligimet e tyre në lidhje me nivelin e shërbimeve;
- Vendosja e standardeve për shërbimet e ofruara për konsumatorët si dhe monitorimi i zbatueshmërisë së tyre nga ana e ofruesve të shërbimeve;
- Sigurimi i mekanizmave për konsumatorët që të parashtrojnë ankesa ndaj ofruesve të shërbimeve;
- Përcaktimi i obligimeve dhe të drejtave të ndërsjellta për ofruesit e shërbimeve dhe konsumatorëve, si dhe monitorimi i zbatueshmërisë së tyre.

Për më tepër një nga funksionet e tij rregullatore është edhe stimulimi i konkurrencës në sektorët e shërbimeve të ujit përmes krahasimit (benchmarking) si dhe raportimit të rregullt të performancës. Roli i monitorimit dhe raportimit nga ana e ZRRUK, po ashtu është i rëndësishëm për shkakun se ofron informata të besueshme dhe të qëndrueshme e që mund të përdoret për të:

- Identifikuar performancën e dobët dhe atë të mirë me qëllim të ofrimit të stimulimit për ofruesin e shërbimit për të përmirësuar punën e tyre me kalimin e kohës.
- lejuar të bëhen krahasime në mes të ofruesve të shërbimeve dhe në këtë mënyrë të lehtësohet konkurrenca nga krahasimi e që mund të inkurajojë ofruesit e shërbimeve për të përmirësuar performancën e tyre në raport me të tjerët si dhe
- mbanë aktorët e përfshirë, të informuar në lidhje me punën dhe aktivitetet e ofruesve të shërbimeve përmes shpërndarjes së informacionit të shërbimit tek publiku, konsumatorët si dhe institucionet (Rregullatorin, Kuvendin dhe Qeverinë e Kosovës) dhe donatorët me qëllim të lehtësimit të vendim-marrjes për ndërmarrjet publike të shërbimeve të ujit.

Për të ushtruar rolin dhe përgjegjësit e saj në mënyrë sa më efektive ZRRUK, punon shumë ngushtë me institucionet dhe organizatat të tjera përgjegjëse në sektor, për të ju mundësuar kompanive të ujit për të përmbushur vizionin e tyre për shërbime të qëndrueshme, efektive dhe me standard të pranueshme për konsumatorë.

## 1 HYRJE

Zyra Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim, ka mandatin për të rregulluar sektorin e shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimeve si rregullator ekonomik në bazë të Ligjit Nr. 03/L-86, përderisa përgjegjësia për furnizim me ujë të pijshëm dhe ofrimin e shërbimeve të kanalizimit është e Kompanive Rajonale të Ujësjellësëve (KRU). Janë gjithsejtë shtatë KRU, të cilat ofrojnë shërbimet e tyre, në shtatë regjionet e Kosovës. Qeveria e Kosovës është aksionare e tyre me përgjegjësin e mbikëqyrjes së afarizmit në bazë të Ligjit Nr. 03/L-087, mbi Ndërmarrjet Publike (NP).

ZRRUK, ka në përdorim një numër të mekanizmave, përfshirë monitorimin e performancës për të sfiduar, Ofruesit e shërbimeve të ujit për të përmirësuar, performancën e tyre në secilën nga fusha e potencuar me lart. Ne kemi vazhduar të mbledhim informacione, rregullatore dhe kemi publikuar gjetjet për arritjet në përmirësimin e objektivave dhe cilësinë e dhënë të shërbimeve, ashtu siç kemi dakorduar në shqyrtimin tarifor të çmimeve për shërbimet e ofruara.

Raporti i performancës, gjithashtu nxjerr në pah performancën e ofruesve të shërbimeve në raport me standardet e shërbimit të cilat rrjedhin nga Rregulla e standardeve minimale të Shërbimeve. Nga ana tjetër, vlerësimi krahasues (Benchmarking) nxit konkurrencën midis KRU duke motivuar një KRU për të përmirësuar, performancën e saj, në raport me performancën e mëparshme si dhe të bëj punën më mirë se kompanitë e tjera simotra.

Raporti përbëhet nga 4 pjesë qendrore (A,B,C dhe D), dhe një numër shtojcash:

**Pjesa A**, është thelbi i këtij raportit ku ne ofrojmë informacione, analiza dhe komente për performancën e shtatë KRU. Në këtë analizë shqyrtohet, performanca relative e KRU në lidhje me shërbimet e furnizimit me ujë, shërbimet për ujërat e zeza dhe menaxhimin financiar/komercial. Kjo pjesë përfundon me vlerësim të performancës së përgjithshme në raport me nivelin ideal të performancës.

**Pjesa B**, Performanca e sektorit të shërbimeve të Ujësjellësit-Kanalizimit, pasqyron performancën e përbashkët të tyre, përmes disa treguesve të rëndësishëm, për një periudhë 3 vjeçare të lidhur me procesin tarifor 2012-2014 me qëllim që të japim një pasqyrë më të çartë të trendeve të zhvillimit të këtyre treguesve.

**Pjesa C**, në vazhdim të raportit, ka shqyrtuar dhe diskutuar performancën e furnizuesit të vetëm që furnizon me shumicë ujë të patrajtuar (NH Ibër-Iepenci), përderisa në,

**Pjesën D**, raportohet mbi rolin dhe performancën e Komisioneve Këshilluese të Konsumatorëve (KKK). Pjesë e raportit janë po ashtu edhe një numër shtojcash të cilat ofrojnë informacione shtesë, të dhëna të detajuara të performancës për secilën KRU.

ZRRUK ka licencuar, shtatë Kompani Rajonale të Ujësjellësëve (KRU) të cilat ofrojnë shërbime të ujit të pijshëm dhe shërbime të ujërave të zeza, si dhe një Kompani që ofron ujë me shumicë për kompanitë e ujësjellësit.

Në këtë raport për Kompanitë Rajonale të Ujësjellësëve (KRU), në raste të caktuara përdoren edhe termat, Ofruesit e shërbimeve të ujësjellësit dhe ujërave të zeza apo Ndërmarrje publike, varësisht prej kontekstit.

Ne shpresojmë që: Ofruesit e shërbimeve të ujit, Rregullatori, Qeveria e Kosovës, Politikë-bërësit, Donatorët dhe grupet e tjera të interesit do të jenë në gjendje që ti përdorin të dhënat (informacionet) në këtë raport si një pikë referimi për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së shërbimeve të ujit dhe kanalizimeve si dhe për të ndihmuar, politikat e ardhshme të lidhura me planifikimet në industrinë e shërbimeve të ujit në Kosovë.

## 2 ZHVILLIMET NË SEKTOR

Edhe viti 2014, po ashtu është karakterizuar me disa zhvillime të rëndësishme si në aspektet: rregullatore ashtu edhe atë të aspektit të përgjithshëm të sektorit të shërbimeve të ujit në vend.

### Tariafat e ujit (2015-2017)

ZRRUK, ka përcaktuar tarifat për shërbimet e ujit dhe shërbimet e ujërave të zeza, që do të zbatohen nga secila prej shtatë KRU, për tre vitet e ardhshme, (2015-2017) duke filluar nga 1 Janari 2015. Gjatë aprovimit të tarifave, janë marrë parasysh aftësinë e konsumatorëve për të paguar faturat e tyre në funksion të ruajtjes së qëndrueshmërisë financiare të KRU. ZRRUK-it, i mbetet detyrë që të monitorojë KRU, që ato të operojnë në mënyrën më efektive të mundshme. Tarifat e reja, kanë paraparë rritje reale të faturave të konsumatorëve shtëpiak për furnizim me ujë dhe shërbime të ujërave të zeza për dy vitet e para (2015 – 2016) për 1.74% në raport me tarifat e vitit 2014, përderisa tarifat e vitit 2017 është paraparë të kenë ngritje për 0.34%. Sa i përket tarifave të konsumatorëve jo-shtëpiak, ato do të kenë ulje nga viti 2015, gjerë në fund të vitit 2017 për 3.73% në krahasim me tarifat e aplikuar gjatë vitit 2014. E që është në përputhje me politikat rregullatore për zvogëlimin e ndërsuvcionimit ndër konsumatorë. Edhe me këtë proces tarifor kompanit, janë sfiduar në fusha të rëndësishme, gjithnjë duke synuar përmirësimin e efikasitetit, (zvogëlimin e shpenzimeve operative, përmirësimin e shkallës së arkëtimit dhe reduktimin e UPF), rritjen e investimeve kapitale (investimeve për furnizim me ujë dhe shërbimet për ujëra të zeza) si dhe rritjen e mbulueshmërisë me shërbime të ujësjetës dhe ujërave të zeza. Aprovimi i tarifave pra, është bërë pas një analize të detajuar të kostove për të hequr shpenzimet e pajustificuara si dhe për të inkurajuar efikasitetin operativ dhe përmirësimin e ofrimit të shërbimeve, ZRRUK po ashtu i mbetet prioritet që të kujdeset për të monitoruar në mënyrë të përkushtuar dhe për të siguruar se të gjitha objektivat e parapara të realizohen nga ofruesit e shërbimeve.

### Strategjia e ZRRUK (2015-2017)

ZRRUK, ka hartuar planin strategjik (2014-2017) të tretin me radhë, i cili paraqet aspiratën e menaxhmentit të saj për një drejtim strategjik të zhvillimit institucional dhe profesional të vetë ZRRUK, por edhe Ndërmarrjeve të rregulluara prej saj. Synimet, objektivat dhe prioritetet e miratuara në këtë plan strategjik, vijnë nga një çasje e gjerë konsultative e menaxhmentit të ZRRUK, me qëllim të vendosjes së drejtë të veprimeve të ZRRUK, përgjatë tri viteve të ardhshme. Për realizimin e këtij plani strategjik, ne jemi duke u mbështetur në përkushtimin dhe angazhimin e kapaciteteve njerëzore dhe profesionale, mbrenda ZRRUK, si dhe në mbështetjen e projektit financiar nga Qeveria Zvicërene (SCO). Në zbatimin e planit strategjik ZRRUK do të donte të pranojë nevojën thelbësore për kordinim cilësor të përpjekjeve të menaxhmentit të KRU dhe aktorëve tjerë të sektorit si një nxitës, kritikë për garantimin e rezultateve të cilat do duhet pritur nga kjo çasje strategjike. Në përgjithësi, Plani Strategjik, do të fokusohet në rritjen e ndërgjegjësimit mbi funksionet e rregullatorit dhe avokimit për zbatimin e legjislacionit nga Ofruesit e furnizimit me ujësjelles dhe kanalizim dhe nga ana e aktorëve të tjerë. Pra, ZRRUK përmes këtij plani do të nxisë ofrimin e shërbimeve të përmirësuar nga Ofruesit shërbimeve dhe ndarjen e njohurive në aspekte të ndryshme të rregullimit.

### Programi i ujit për Danubin (IAWD)

Ka vazhduar bashkëpunimi i sektorit të shërbimeve të ujit të Kosovës me Programin e Ujit për Danubin i cili vepron në kuadër të shoqatës ndërkombëtare të ujit për vendet e Danubit (IAWD) me mbështetje të Bankës Botërore. Në këtë program, është përfshirë edhe Kosova, krahas 12 shteteve të rajonit të Danubit, (Austria, Shqipëria, Ukraina, Rumania, Moldavia, Bullgaria, Maqedonia, Serbia, Kroacia, Bosnja e Hercegovina dhe Mali i Zi). Programi ka si synim të ju ndihmojë këtyre vendeve në ndërtimin e shërbimeve të forta dhe të qëndrueshme të ujësjetës dhe shërbimeve të ujërave të zeza. ZRRUK, krahas aktereve tjera të shërbimeve të ujit nga Kosova, ka qenë pjesë aktive e të gjitha ngjarjeve të organizuara prej saj, (Konferenca, Grupet drejtuese, Trajnime) me pjesëmarrjen e zyrtarëve përgjegjës nga institucionet e sektorit, Përfitimet nga ky program kanë qenë të mëdha sidomos në ngjirtjen e kapaciteteve profesionale të

zyrtarëve pjesmarrës. Vlenë të theksohet se për ZRRUK, programi ka siguruar një hapsire të konsiderueshme të pjesmarrjes dhe konsultimit, meqenë nga menaxhuesit e projektit është parë si institucion i konsoliduar, sidomos në fushën e monitorimit dhe vlerësimit të performancës së Ofruesve të shërbimeve të ujit, dhe është paraqitur kudo si shembull i mirë. Për më tepër nën organizimin e Bankës Botërore/IAWD. Programi i ujit të Danubit në bashkëpunim me Qendrën e kërkimeve komunale publike nga Universiteti i Floridës ka zhvilluar një seminar pesë ditor, nga data: 23-27 shkurt, 2015 në Prishtinë, Kosovë. Me temë: **'Benchmarkingu Rregullator - Vlerësimi dhe përmirësimi i Performancës'**. Qëllimin i këtij takimi ka qenë, ndërtimi i kapaciteteve dhe shkëmbimi i praktikave më të mira mes këtyre vendeve, në mbledhjen e të dhënave dhe analizën për vlerësimin e performancës dhe përmirësimin e shërbimeve. Nën mbështetjen e programit është zhvilluar edhe Platforma e DANUBISIT, si një Web faqe e përbashkët e të gjitha vendeve të regjionit të Danubit. Çdo vend antarë e ka edhe portalin e vetë i cili duhet menagjuar dhe përditësuar nga secili vend në mënyrë individuale. ZRRUK, ka marrë përsipër, përditësimin e të dhënave në Data Bazen e portalit për Kosovën e vlefshme si në aspektin e përgjithshëm të shërbimeve e veçanarisht e vlefshme për bashkëpunimin regjional në fushën e Benchmarkingut. Në konferencën e Ujit të DANUBIT- 2015, të mbajtur me datë 06-08 maj 2015 në Vjenë, Austri, pjesmarrës në të cilin ishin një numër zyrtarësh nga institucionet relevante të Kosovës nga fusha e ujërave. Në këtë rast u informuam se 'Programi i Ujit të DANUBIT', do të vazhdojë edhe më tejë përmes fazës së II –tani me të filluar 2015 - 2018, në mbështetjen e BB. Me synimin se Bashkëpunimi ndërmjete vendeve të Danubit, do të vazhdojë edhe përtej 2018. Edhe në këtë rast ne inkurajojmë institucionet vendore të shërbimeve të ujit të jenë sa më pro aktive në bashkëpunim me programin, meqenëse mundësia e perfitimeve, është shumë e madhe.

#### **Programi mbështetës për Ujësjellës dhe Kanalizim në Zonat Rurale-faza e V-të**

Nën mbështetjen me fonde nga Qeveria Zvicrane (SCO) dhe Qeveria e Kosovës, dhe implementuesve Dorsche Gruppe dhe CDI, në vitin 2014, ka filluar implementimi 'Programi mbështetës për ujësjellës dhe kanalizim në zonat rurale-faza e V-të. Ky program është në vazhden e mbështetjes së vazhdueshme që Qeveria Zvicriane, ka dhënë që nga pas lufta, sektorit të shërbimeve të ujit me qëllim të rritjes së çasjes së popullatës me ujë të pastër dhe shërbime të kanalizimit. E veçanta e programit në këtë fazë është synimi për të kontribuar në menaxhimin e qëndrueshëm të sistemeve të ujësjellësëve dhe kanalizimeve në mbarë vendin. Për dallim nga 4 fazat e mëparshme, ku programi ka qenë i fokusuar në përmirësimin e furnizimit me ujë të pijëshëm dhe kanalizime në zonat rurale. Këtë program është duke e mbështetur edhe Qeveria e Kosovës me fonde të konsiderueshme. Program i cili do të vazhdojë deri në vitin 2017, përveç tjerash është edhe në funksion të mbështetjes së drejtpërdrejt të 'Strategjis për menaxhimin e sistemeve rurale të ujësjellësit' të hartuar nga Qeveria e Kosovës, në vitin 2014. Prej 1,262<sup>1</sup> fshatrave të Kosovës me sisteme të veçanta të ujësjellësit të cilat nuk administrohen nga KRU-të, janë edhe 242 fshatra (me 205,570 banorë), ose 19% të popullsisë rurale të Kosovës. Po ashtu, janë edhe 48 fshatra shtesë me 48,382 banorë, që kanë qasje në sisteme të veçanta të ujësjellësit të cilat aktualisht, janë jashtë funksionit si rezultat i keqmenaxhimit. Disa nga sfidat e pritshme që kanë të bëjnë me: mungesa e vullnetit të KRU-ve për integrimin e këtyre sistemeve, rezistenca e komunitetit që ta japin në menaxhim të KRU-ve sistemin e "tyrë" të ujësjellësit si dhe transferimi i asetëve nga komuna të KRU-të, etj. Si duket me një kordinim të mirë ndërmjet të gjitha institucioneve relevante Qeveritare, ZRRUK, IKSH, Komunave, Komunitetit si dhe me programin RWSSP V, janë duke u tejkaluar. Pra, është shprehur gadishmëria e të gjitha palëve (KRU, Pushteteve lokale dhe Komuniteteve) për të pranuar kushtet e programit për lejimin e investimeve.

<sup>1</sup> Strategjis për menaxhimin e sistemeve rurale të ujësjellësit'

## Pjesa A:

# Performanca e Kompanive Rajonale të Ujësjetës-Kanalizimit

---

### 3 PERFORMANCA E KRU

#### 3.1 Furnizimi me ujë

Në këtë pjesë të Raportit, është paraqitur analiza dhe komentimi për performancën individuale të KRU në treguesit kryesorë të performancës, përndryshe në SHTOJCËN 1, janë dhënë statistikave të detajuara të performancës në formë tabelare, në mënyrë të veçantë për secilin nga shtatë KRU. Këtu pra, ZRRUK ka shpalosur performancën e treguar nga KRU për vitin 2014, në fushat kyçe të punës, përfshir aspektet: operative, financiare dhe shërbimeve ndaj konsumatorëve, ndaras për të dyja shërbimet (furnizim me ujë dhe shërbime të ujërave të zeza), gjithnjë duke e krahasuar me performancën e treguar gjatë vitit paraprak 2013. Në disa raste aty ku ka pasuar mundësi është vlerësuar, përmbushja e objektivave në raport me pritjet e planifikuara përmes Biznis Planeve Rregullatore (BPRR) të aprovuara nga Rregullatori, gjatë procesit tariforë.

##### 3.1.1 Performanca teknike

Paraqet cilësinë e shërbimit të furnizimit me ujë nga aspekti operativ (teknik) që kompanitë e kanë ofruar për konsumatorët e tyre. Janë pesë (5) treguesit me reprezentativ përfshirë: kualitetin e ujit, presionin në rrjetë, vazhdimësin e furnizimit dhe plasjen e gypave si dhe Uji e Pafaturuar, të cilët më së miri pasqyrojnë performancën e treguar nga KRU.

##### Kualiteti i ujit

Kualiteti i ujit, është një ndër treguesit me të rëndësishëm për shkak të ndikimit, që ka në shëndetin e konsumatorëve. Pajtueshmëria e kualitetit të ujit merr parasysh numrin total të mostrave të testuara në raport me numrin e mostrave, testeteve e të cilave nuk i përmbushin vlerat parametrike në bazë të standardeve të përcaktuara kombëtare. Në këtë rast është e rëndësishme të theksohet se një shkallë e ultë e pajtueshmërisë do të thotë mangësi në kualitetin e ujit. Janë dy komponente të analizuar mbi kualitetin e ujit: Aspekti bakteriologjik dhe fiziko- kimik. Analizën dhe gjendjen e kualitetit të ujit të pijës të ofruar nga kompanitë për vitin 2014 në raport me 2013, edhe këtë vit, ZRRUK e ka bërë në bazë të dhënave të raportuara nga Qendra e monitorimit të ujit të pijes (IKSHPK) si institucion përgjegjës për monitorimin dhe garantimin se uji i distribuar nga KRU, është i pijshëm dhe në përputhje me vlerat parametrike të kuadrit ligjor.




Figura 1, Rezultatet e testimit të cilësisë së ujit

Në fig. 1 dhe tabelën 1, është dhëna në mënyrë grafike, respektivisht tabelare, përqindëja e mostrave të testuara të cilat janë në përputhje me standardet për kualitetin e ujit të pijshëm.

Në vitin 2014 cilësia e ujit e ofruar nga KRU, ka qenë përgjithësisht e kënaqshme dhe në përputhje me Udhëzimin Administrative 16/2012. Megjithatë, ka pasur disa shqetësime momentale në KRU (Prishtina dhe Hidromorava, Hidroregjioni Jugor), të cilat janë adresuar dhe shpejtë është kthyer cilësia e duhur e ujit.

**Tabela 1, Kualiteti i ujit të pijëshëm**

Kategoria e Konsumatorëve	KRU Prishtina		KRU Hidroregjioni Jugor		KRU-Hidrodrini		KRU Mitrovica		KRU Radoniqi		KRU Bifurkacioni		KRU Hidromorava	
	2013	2014	2013	2014	2013	2014	2013	2014	2013	2014	2013	2014	2013	2014
% e kalimit të testeve bakteriologjike	99.4	99.5	97.0	88.0	98.6	97.7	98.7	99.0	99.8	98.5	97.5	99.3	98.0	99.2
% e kalimit të testeve fiziko-kimike	100.0	99.2	98.2	99.6	89.5	96.3	96.2	98.1	99.7	100	99.4	100	99.5	100

Në total janë 11,286 mostra të analizuar nga IKSHPK në vitin 2014, prej të cilave 7,794 i janë nënshtruar testeve mikrobiologjike, përderisa dështimet, janë evidentuar në 221 sosh apo 2.8%. Kjo d.th. se 97.2% e mostrave janë në përputhje me vlerat parametrike të standardeve vendore. Në aspektet fiziko-kimike, janë analizuar gjithsej 3,492, mostra dhe vetëm 36 prej tyre apo 1.0%, nuk i kanë përmbushur vlerat parametrike të standardeve.

Në përgjithësi kualiteti i ujit në mesatare të sektorit ka rënë nga 98.4% gjatë vitit 2013 në 97.7% për vitin 2014.

Dështimet më të mëdha bakteriologjike, gjatë vitit 2014, janë regjistruar në zonen e shërbimit të KRU 'Hidroregjioni Jugor' me 88%, dhe në raport me vitin 2013, është shënuar, rënje e konsiderueshme prej 9% e kualitetit të ujit. ZRRUK në bashkpunim me IKSHPK dhe KNMU e kanë adresuar tek menaxhmenti i KRU 'Hidroregjionit Jugor', këtë shqetësim sa i përket këtyre dështimeve. Ka qenë konstatim se në përgjithësi, janë disa pika të identifikuar në të cilat, janë paraqitur dështimet e kualitetit të cilat në vazhdimësi kanë qenë në cakë të monitorimit dhe analizave deri në përmirësim.


Progres sa i përket, aspektit mikrobiologjik të cilësisë së ujit gjatë vitit 2014 në raport me vitin paraprak 2013, kanë shënuar KRU (Prishtina, Hidromorava, Bifurkacioni, Mitrovica), përderisa kualitetin më të mirë ujit në aspektin mikrobiologjik e ka ofruar KRU 'Prishtina' me 99.5%, kalueshmeri të testeve.

Aktualisht dështimi i kualitetit të ujit në shkallë më të lartë nga aspekti fiziko-kimik, vazhdon tek KRU 'Hidrodrini', (Nj.O Klinë), me prezencën e manganit (Mg) dhe të Nitriteve (NO<sub>2</sub>), me vlera shumë të larta edhe pse në 2014/2013 është shënuar progres nga 89.5% në 96.3%. Edhe në aspektin mikrobiologjik, kjo kompani ka shënuar performancë më të dobët gjatë vitit 2014/2013.

### **Presioni i ujit**

Ky tregues, paraqet numrin e pronave që preken nga presioni i ultë. Presioni i ultë zakonisht ka ndodhë në zonat e banimit të cilat kanë shtim të vazhdueshëm të popullatës si dhe zonave që ndodhen në kuotat e larta gjeodezike. Presioni i pamjaftueshëm mund të ndodhë edhe për arsyen kur kompanit nuk kanë kapacitete të mjaftueshme të pompimit, apo për shkakun e rrjetit të vjetërsuar.

Eshte evidente se menaxhimi i duhur presionit, përveq ndikimit të drejtpërdrejtë që ka në kënaqshmërin e konsumatorëve me shërbimin e ofruar, është edhe njëri prej elementeve të rëndësishëm në menaxhimin e humbjeve fizike të ujit si dhe ruajtjen e jetëgjatësisë së rrjetit të ujësjellësit. Eshte obligim ligjorë që furnizuesit vendor të marrin përsipër të sigurojnë një furnizim në një "nivel referimi" mbi 25 m.sh.u.




**Figura 2, % e Konsumatorëve të furnizuar me presion të ultë.**

Gjatë vitit 2014, KRU ‘Hidromorava’, ‘Radoniqi’ dhe KRU ‘Prishtina’, kanë raportuar të dhëna për pronat të cilat kanë probleme me sigurimin e presionit adekuat të ujit. Nga KRU e tjera, nuk ka qenë e mundur të sigurohen të dhëna. Në përgjithësi të dhënat për presionin e ujit, ende duhet konsideruar si jo fort të besueshme meqenëse asnjëra nga kompanitë nuk ka ndonjë program të mirëfillt rreth menagjimit dhe monitorimit të presionit si dhe mbajtjes së evidencës. Është mundshme që situata të jetë edhe më e keqe se sa tregon figura 2. sido që të jetë nga analiza e të dhënave për vitin 2014, duket se nuk ka pasur ndonjë shqetësim të madhë në këtë drejtim. Në nivel të sektorit, performanca në këtë tregues është me e përmirësuar se sa ishte në vitin 2013 prej 2%.

Pra 2% e konsumatorëve, ende do të vazhdojnë të presin furnizuesit e tyre për të siguruar një furnizimi me ujë në një presion që është i mjaftueshëm për nevojat e shpenzimeve te kategorisë së amvisëris (ujë të pijshëm për pastrimi, larje dhe gatim).

**Vazhdimësia e furnizimit**

Në Figurën 3, dhe tabelen 2, është pasqyruar % e numrit të konsumatorëve për të cilët furnizimi me ujë ishte në dispozicion gjatë periudhës raportuese. Vazhdimësia e furnizimit me ujë, është e ndarë në tri grupime: (i) konsumatorë me 24 orë shërbim në ditë, (ii) konsumatorë me 18-23 orë shërbim në ditë dhe (iii) ato me më pak se 18 orë shërbim në ditë. Ky është një tregues i rëndësishem i cilësisë së shërbimit, besueshmëris dhe kënaqshmëris së konsumatorëve.



**Figura 3, Vazhdimësia e furnizimit me ujë për vitin 2014,**

Në gjysmën e parë të vitit 2014, vendi është karakterizuar me një periudhë me thatësi ekstreme, Zonat e shërbimit të KRU ‘Prishtina’ dhe ‘Hidromorava’, kanë qenë më së shumiti të prekura nga kjo thatësi dhe atë

për faktin se kanë pasur një deficit të konsiderueshem të resurseve ujore në burimet e tyre. Kjo ka shkatuar që krahas reduktimeve të zakonshme për një periudhë, kohëzgjatja e reduktimeve të rritet dhe të përfshijë edhe një numër të konsiderueshëm të konsumatorëve tjerë. Pra, është shënuar një performancë më e dobët në këto dy KRU. Ky faktë pra, ka ndikuar që performanca e sektorit të bije nga 59.2% gjatë 2013 në 57,3% në 2014. Kjo do të thotë se rreth 43% e konsumatorëve ju kanë nënshtruar reduktimeve. Gjithëashtu edhe tek kategoria 18-23 orë, kemi përqindje më të madhe (26.8%) të konsumatorëve tek të cilët furnizimi ka qenë më pakë se 18 orë.

**Tabela 2, Furnizimi me Ujë të pijës**

Furnizimi në orë	24 orë Furnizim me Ujë		18-23 orë Furnizim me Ujë		<18 orë Furnizim me Ujë	
	2013	2014	2013	2014	2013	2014
<b>Vitet</b>						
<b>PR</b>	22.3%	17.8%	38.4%	25.9%	39.2%	56.3%
<b>FE</b>	11.4%	31.2%	87.9%	68.8%	0.8%	0.0%
<b>GJI</b>	99.2%	57.8%	0.8%	0.7%	0%	41.5%
<b>MIT</b>	40.1%	61.7%	7.1%	15.4%	52.7%	22.9%
<b>GJA</b>	99.2%	98.1%	0%	0.6%	0.8%	1.3%
<b>PZ</b>	98.2%	98.6%	0%	0.6%	1.8%	0.9%
<b>PE</b>	99.3%	99.4%	0.7%	0.6%	0%	0.0%
<b>MES</b>	<b>59.2%</b>	<b>57.3%</b>	<b>20.9%</b>	<b>15.8%</b>	<b>19.9%</b>	<b>26.8%</b>

Kompani e cila, ka arritur të furnizojnë konsumatorët e saj pothuajse 24 orë me ujë të pijshëm është KRU 'Hidrodrini', duke vazhduar me dy kompanite tjera KRU 'Hidroregjionin Jugor' dhe 'Radoniqin' mbi 98% furnizim 24 orë me ujë të pijes. Probleme me furnizim të ujit në këto tri kompani, janë prezente herë pas here gjatë sezonit të verës. Në përjashtim të KRU 'Prishtina' dhe 'Hidromorava', gjatë vitit 2014, gati të gjitha kompanitë kanë shënuar progres në vazhdimësin e furnizimit. Është evidente një përmirësi i ndjeshëm në zonen e furnizimit të KRU 'Mitrovica', si rezultat i hyrjes në funksion të fabrikës së re në Shipol e cila ka rritur kapacitetet e saj për rreth 50%.


### **Plasja e gypave**

Paraqet, numrin e defekteve (plasjeve) në baza vjetore për 100 km gjatësi të gypave, në sistemin e shpërndarjes i cili është nën përgjegjësin e menaxhimit të kompanisë. Niveli i defekteve në rrjetin kryesorë të furnizimit, kryesisht është ndikuar nga një sërë faktorësh, duke përfshirë llojin (materialin) e gypave, vjetërsinë e rrjetit, standardin e mirëmbajtjes së kryer nga ofruesi i shërbimit, etj.

Gjatë vitit 2014 numri i defekteve në rrjetin e ujësjellësit për 100 km gjatësi në nivel sektori është raportuar të jetë në nivel më të ultë (më i përmirësuar), nga 363 (defekte për 100 km) në vitin 2013 në 279 gjatë vitit 2014.

Në krahasim me vitin 2013 gjatë vitit niveli i plasjeve për 100 km të rrjetit në KRU 'Hidromorava', ka rënë nga 1.745 në 625.

Po ashtu edhe në KRU 'Prishtina', numri i defekteve ka rënë në mënyrë të ndjeshme, nga 213 në 148 defekte për 100 km të gjatësisë së rrjetit kjo siç duket është rezultat i investimeve direkte në rrjetë.




**Figura 4, Plasjet e gypave të ujësjellësit**

Përmirësim sa i përket këtij treguesi, gjatë vitit 2014 krahasuar me vitin 2013 kanë shënuar KRU 'Hidromorava', 'Prishtina' dhe KRU 'Hidrodrini'. Përderisa sistemi i rrjeteve në KRU 'Bifurkacioni', 'Mitrovica', 'Radoniqi' dhe 'Hidroregjioni Jugore', janë ato të cilat kanë treguar performancë më të dobët në vitin 2014. Ky faktë duhet të ju shërbej këtyre kompanive si indikacion për ndërmarrjen e investimeve në mirëmbajtjen dhe ripërtëritjen infrastrukurore, me qëllimin për të ndaluar trendin negativ të defekteve.

#### **Uji i pa-faturuar (UPF)**

**UPF si vlerë sasiore**, është një masë e ujit të humbur në sistemin e shpërndarjes. Kjo pra, është diferenca në mes të sasisë së ujit të trajtuar të shpërndarë në rrjetë dhe sasisë së ujit të faturuar. UPF përbëhet nga humbjet teknike (rrjedhjet) dhe humbjet komerciale (lidhjet e paligjshme, konsumatorët e pa faturuar, humbjet në ujëmatësit e konsumatorëve).




**Figura 5, Uji i pa-faturuar (sasi absolute)**

Në nivel sektori humbjet e ujit në vlerë sasiore 2014/2013, janë zvogluar mbi 1.6 milion m<sup>3</sup>. Ndikim të zvoglimi i humbjeve ka direkt zvoglimi i prodhimit të shumica e kompanive.

Kompanitë tek të cilat UPF në vlerë sasiore ka shënuar rritje gjatë vitit 2014 në raport me vitin 2013, janë KRU 'Mitrovica', 'Hidrodrini', dhe 'Hidromorava'. Edhe përkundër rritjes së prodhimit të ujit tek KRU 'Mitrovica' për shkak të zgjerimit të kapacitetit prodhues nga mesi i vitit 2014, prapë UPF nuk ka shënuar ndonjë përmirësim.

Ndërsa sa i përket rritjes së humbjeve në vlerë sasiore gjatë vitit 2014/2013 te KRU 'Hidrodrini' edhe përkundër një rritjeje të faturimit, është rritja me e madhe e prodhimit që ka ndikuar në rritjen e UPF.

**Uji i pa-faturuar litër për konsumatorë në ditë dhe i rregulluar**, për orët e furnizimit me ujë (vazhdimësin e furnizimit), paraqet sasin mesatare të UPF, në raport me totalin e konsumatorëve në zonën e shërbimit.



**Figura 6, Performanca krahasuese për UPF, paraqitur (l/k/d) dhe si (%)<sup>3</sup>**

Në nivel sektori gjatë vitit 2014/2013, UPF liter për konsumatorë në ditë si mesatare ka shënuar progres. Nga figura 6, vërehet se të gjitha kompanitë me përjashtim të KRU 'Mitrovica' dhe 'Hidromorava', kanë shënuar zvoglim të humbjeve l/k/d.

Performanca më e mirë sa i përket UPF, liter për konsumatorë në ditë e rregulluar për orët e furnizimit me ujë është shënuar në KRU 'Bifurkacioni', me humbjet më të vogla në vitin 2014 prej 550 l/k/d.

**UPF si përqindje e prodhimit të ujit (%)**, në këtë seksion UPF është vlerësuar si përqindje e sasisë së ujit të shitur në raport me sasinë e ujit të prodhuar. Pra, është treguesi më i zakonshëm që përdoret për të vlerësuar nivelin e humbjeve të ujit. Edhe pse është i lehtë për tu kuptuar nga publiku i gjerë dhe është duke u përdorur gjerësisht, egziston një perceptim i përgjithshëm në qarqe të ndryshme profesionale se ky, nuk është një tregues më i përshtatshëm për vlerësimin e nivelit të humbjeve të ujit. Sido që të jetë UPF, mbetet një sfidë e madhe në këtë sektor dhe atë për të gjitha KRU pa përjashtim. Niveli i ujit të pafaturuar shprehur në përqindje në mesatare të sektorit gjatë vitit 2014, është në nivelin 57.6%. në raport me vitin 2013. UPF pra, ka shënuar përkeqesim për 0.6%.

Në KRU 'Mitrovica', është shënuar një trendë më i lartë i UPF, në vitin 2014 nga 50%, sa ishte në vitin 2013, në vitin 2014, ajo u rritë në 59%. Trendi në rritje i UPF, në këtë kompani, vije si rezultat i shtimit të kapacitetit prodhues dhe mungesës së efikasitetit të faturimit.

Në shumicën e KRU në vitin 2014/2013, është shënuar pak progres. KRU 'Prishtina' me nivelin e UPF prej 49%, gjatë vitit 2014, është në pozicion më të mirë se kompanitë e tjera edhe pse ky nivel është shumë i lartë, përmirësimet në vazhdimësi për një përqindje të vogël (jo vetëm në këtë kompani), më shumë mund ti atribuohen, levizjeve të prodhimit se sa rritjes së dëshiruar të faturimit të ujit.

Nga ana tjetër, kompania me nivelin më të lartë të UPF (71%), edhe këtë vit, vazhdon të jetë KRU 'Hidrodrini'.

<sup>3</sup> Vlera e UPF për kycje në ditë është përshtatur/rregulluar që të kompensojë orët e shërbimit në ditë.


KRU duhet që përmes veprimeve të planifikuara ti qasen problemit të reduktimit të UPF. Fillimisht me koncentrim në reduktimin e humbjeve komerciale e cila është një fushë me potencialin më të madhë të reduktimeve dhe njëkohësisht me një kosto të ultë, pa i anashkaluar reduktimin e humbjeve fizike të cilat konsiderohen se kanë një kosto shumë herë më të lartë.

### 3.1.2 Performanca komerciale

Kjo pjesë e raportit, paraqet analizen dhe diskutimin e cilësisë së shërbimit që KRU, kanë bërë për konsumatorët e tyre. Treguesit të cilët me së miri pasqyrojnë, performancën në këtë aspekt janë: Mbulueshmëria me shërbime të furnizimit me ujë, matja e ujit dhe trajtimi i ankesave të konsumatorëve.

#### Mbulueshmëria me shërbime të ujit

Mbulueshmëria me shërbime të furnizimit me ujë është e definuar si përqindja e popullsisë brenda zonës së shërbimit që kanë shërbim të furnizimit me ujë. Ky tregues është analizuar duke marrë për bazë të dhënat e dala nga regjistrimi i fundit i vitit 2011, për ekonomitë familjare nga ASK si dhe numrin e konsumatorëve aktiv për kategorinë e amvisëris të dhëna të raportuara nga KRU.



**Figura 7, Mbulueshmëria me shërbime të ujësjellësit**

Mbulueshmëria me shërbimin e furnizimit me ujë në nivel sektori ka shënuar progres për 2%, dhe në vitin 2014, ka arritur nivelin prej 84%.

Fluksi i madhë i lëvizjes së banorëve nga qytetet tjera drejtë kryeqytetit dhe mos regjistrimi i tyre si ekonomi familjare përkundër regjistrimit të tyre si konsumatorë nga ana e KRU 'Prishtinës', ka bërë që ky tregues për KRU 'Prishtina', të duket jo i besueshëm. ZRRUK ka kërkuar nga ASK, përditesimin më të ri të të dhënave për ekonomitë familjare<sup>4</sup>, por deri në botim të raportit nuk kemi marrë ndonjë përgjigje.

Shkallën më të ulët të mbulueshmërisë me shërbimet e ujit, gjatë vitit 2014 e ka shënuar KRU 'Mitrovica', me 63% edhe pse në raport me vitin 2013 ka shënuar rënje për 1%. Në përgjithësi shumica e KRU në vitin 2014, kanë shënuar performancë më të mirë në këtë tregues në raport me vitin 2013, me përjashtim të KRU 'Radoniqit' dhe 'Mitrovicës'.

Progresin më të madhë në vitin 2014 në raport me 2013 e ka shënuar KRU 'Bifurkacioni', dhe kjo për arsye të zgjerimit të zonës së shërbimit. Numri i konsumatorëve në këtë kompani është rrit për mbi 1,500 sish.

<sup>4</sup> ZRRUK, për vlersimin e mbulueshmërisë me shërbime, perdore statistikën për Ekonomitë familjare të marra nga ASK dhe Numrin e Konsumatorëve të cilve ju lëshohen fatura nga KRU, prandajë terheqim vëmendjejen për ndonjë devijim të mundshëm në vlersim, për shkak të mos përditesimit të dhënave për ekonomitë familjare.

### Matja e ujit

Ky tregues, paraqet proporcionin e konsumatorëve të paisur me ujëmatës funksional të ndarë me numri e përgjithshme të konsumatorëve të kompanisë për periudhën e shqyrtimit 2014. Ujëmatja është e nevojshme në mënyrë që të matet sasinë e ujit të konsumuar, si dhe për të ngarkuar konsumatorët me konsumin e tyre real. Për më tepër ujëmatja është një mjet i rëndësishëm i një kompanie për të menaxhuar me sasinë e ujit të prodhuar dhe të shitur.



**Figura 8, Proporcioni i konsumatorëve shtëpiak me ujëmatës**

Në figurën 7, është paraqitur proporcioni i konsumatorëve shtëpiak të cilët janë paisur me ujëmatës në raport me totalin e konsumatorëve shtëpiak të shërbyer.

Kompania e cila edhe gjatë vitit 2014, prin me proporcionin më të lartë të konsumatorëve shtëpiak me ujëmatës është KRU 'Prishtina' me 98%, mbulueshmëri. Përderisa kompania e cila ngel në nivelin më të ultë është KRU 'Mitrovica', me vetëm 64% është inkurajues fakti se krahasuar me vitin 2013, përmes programit të paisjes së konsumatorëve me ujëmatës tek kjo kompanikemi progres për 5%.

Ritje të mbulueshmeris me ujëmatës, gjatë vitit 2014, kanë shënuar të gjitha KRU perjashtuar dy KRU (Hidromorava dhe Hidrodrini).

Gjatë vitit 2014 nga të gjitha KRU, janë raportuar të jenë vendosur mbi 6,000 ujëmatës të rinjë, për kategorinë e amvisërisë. Proporcioni i përgjithshëm i konsumatorëve me ujëmatës në vitin 2014 është rritur në nivelin 92%.

Duhet të theksohet se rritja e ngadaltë e shkallës së proporcionit të konsumatorëve me ujëmatës, ndikohet edhe nga nevoja për të zëvendësuar ujëmatësit e dëmtuar dhe jo funksional të cilët po ashtu, janë me një masë të konsiderueshme në të gjitha KRU.

### Ankesat

Konsumatorët kanë të drejtë për t'u ankuar kur ata nuk marrin shërbimin e garantuar nga ofruesi i tyre i shërbimeve. Ankesat janë kritike në matjen e kënaqëshmërisë së konsumatorëve. Ofruesit e shërbimeve duhet të bëjnë trajtimin e tyre brenda afatit kohor të përcaktuar si dhe të mbajë një regjistër të përditësuar për ankesat e konsumatorëve.

Ky tregues, paraqet numrin e përgjithshëm të ankesave të pranuar nga KRU, prej konsumatorëve për shërbimin e ujësjellësit apo kanalizimit dhe paraqet, shprehjen e pakënaqësis të proceduar në formë të shkruar apo verbale. Një reduktim në numrin e ankesave mund të tregojë përmirësim në shërbim poashtu mund të tregojë që konsumatorët po humbasin besimin në ofruesit e shërbimeve sepse ankesat e tyre nuk po shqyrtohen.




Figura 9, Ankesat për furnizim me ujë

ZRRUK ka kërkuar nga kompanitë që të raportojnë, numrin total të ankesave të konsumatorëve të specifikuar në dy kategori: (i) Ankesat teknike, të cilat kryesisht janë të lidhur me aspektet operative si dhe (ii) Ankesa komerciale të cilat janë të lidhura me aspektet financiare.

Numri i ankesave për shërbimet e ujit gjatë vitit 2014 në total arrin vlerën 19,576, ku prej tyre 12,653 apo 2/3 janë ankesa të natyrës teknike, janë të lidhura direkt me rrjedhjet e ujit në rrjetin e ujësjellësit apo edhe aspektet e tjera operative ndërsa 6,923 apo 1/3, janë ankesa komerciale, që kryesisht kanë të bëjnë me kontestimet e borxhit dhe parregullsit, rrethë mënyrës së faturimit. Numri i ankesave të paraqitura nga ana e konsumatorëve si atyre teknike dhe komerciale për shërbimet e ujit gjatë vitit 2014, ka shënuar rritje për 1,365 ankesa apo 7%. Numrin më të madhë të ankesave të adresuara për furnizim me ujë për vitin 2014, e ka KRU 'Prishtina', me 10,771, apo në mesatare 100 ankesa për 1000/konsumatorë.

Më pak ankesa, janë adresuar tek KRU 'Radoniqi', 397 ankesa për vitin 2014, prej të cilave vetëm 10 janë ankesa teknike ndërsa 387 ankesa komerciale, në mesatare në këtë kompani, janë parashtruar 13 ankesa për 1000/konsumatorë.

Mesatarja e ankesave në sektorë në vitin 2014 është 68 ankesa për 1000/kons.

Rritja e numrit të ankesave në vazhdimësi vit pas viti është edhe për shkakun se konsumatorët kanë filluar të vetëdijësohen dhe të binden se ja vlen për tu ankuar, meqënëse shumica e kompanive, gjithnjë e më shumë janë të përkushtuara për ti rexhistruar, shqyrtuar dhe azhurnuar në mënyrë sa më të rregullt dhe të shpejtë ankesat e adresuara nga konsumatorët. Kur një konsumator ka arsye për ankesë, arsyet shpesh janë të pakëndshme dhe ndonjëherë shumë serioze. Prandaj është veçanërisht e rëndësishme që ankesa e konsumatorit të trajtohet mirë. Përgjigjeja për të, duhet të jetë e shpejtë, relevante dhe e lehtë për t'u kuptuar.

### Volumi i ujit të shitur

Ky tregues paraqet, volumin e ujit të shitur të realizuar në raport me vlerësimet e planifikuara ashtu siç janë përcaktuar në aplikacionet tarifore të KRU, gjatë procesit tarifor (2012-2014).




Figura 10, Shitjet e ujit në raport me shitjet e planifikuara gjatë rishikimit tarifor (2012-2014)

Në nivel sektori shitjet e realizuara në raport me ato të planifikuara, kanë shënuar performancë më të dobët. Nga 89% sa ishin gjatë vitit 2013 kanë rënë në 84%. Për vitin 2014 nga të gjitha KRU, kanë qenë planifikuar të shiten mbi 61 milion m<sup>3</sup> ujë, përderisa kanë arritur të realizojnë rreth 52 milion m<sup>3</sup>, që është më pak për mbi 9.7 mil. m<sup>3</sup>.

Kompania e cila gjatë vitit 2014, ka qenë më së largu në përmbushjen e synimit të shitjeve të ujit është KRU 'Prishtina' me vetem 74%, për me teper në krahasim me vitin paraprak 2013, kjo kompani ka shënuar performancë më të dobët për 8%.

Mos arritja e objektivave të shitjet sasiore (volumetrike) të ujit ka shkaktuar, që kompanitë mos të kenë të ardhura të planifikuara për të përmbushur nevojat e tyre financiare, sidomos në realizimin e investimeve të lejuara kapitale.

### 3.1.3 Performanca Financiare<sup>5</sup>

Në këtë nen-seksion të raportit, janë vlerësuar treguesit financiar përmes të cilëve është pasqyruar qëndrueshmëria financiare e KRU në: faturim, kostot operative dhe kapitale për shërbimin e furnizimit me ujë.

#### Vlera e shitjeve (EUR)

Vlera totale e shitjeve të ujit është një tregues i rëndësishëm i performancës financiare përmes të cilës mbulohen shpenzimet operative dhe mirëmbajtja kapitale. Rreth 90% e të hyrave të KRU, realizohen nga shërbim të furnizimit me ujë. Pra, janë të ardhurat që KRU kanë marrë për sigurimin e furnizimit me ujë duke përjashtuar të ardhurat e tjera ad-hoc, të cilat ato kanë mundur ti realizojnë.

Niveli i realizimit të shitjeve (faturimi) për shërbimet e ujit në raport me objektivat e dakorduara me BPRR (2012-2014) për vitin 2014, është paraqitur në figurë 11.

<sup>5</sup>Të gjitha vlerat e shprehura në euro, janë të rregulluar sipas çmimeve bazë për vitin 2014, për të siguruar krahasime të duhura nga viti në vit.




Figura 11, Vlera e shitjeve të furnizimit me ujë në raport me shitjet e planifikuara

Si në nivelin individual të KRU, ashtu edhe në nivel të përgjithshëm mesatar, ka vazhduar trendi i mos realizimit të projeksioneve në vlerën e shitjeve. Vlera totale e projektuar e shitjeve në 2014, ka qene 33.4 mil.€, përderisa janë realizuar 25.4 mil.€, apo 76% dhe kjo është më e ultë për 6% nga ajo e cila ishte arritur në vitin 2013. Përderisa në vitin 2013, vlera e realizimit të shitjeve të ujit ka qenë 25.94 mil.€, në vitin 2014, nga të gjitha KRU, kanë mundur të faturonjë gjithësejt 25.24 mil.€, dhe kjo është më pak për 0.634 mil.€ apo 2.45%, me ultë se më vitin krahasues 2013.

Planifikimet në vlerën e shitjeve në BPRR, natyrshëm janë në rritje vit pas viti nga KRU. Për vitin 2014, pritjet për shitje kanë qenë më të larta për 6% në raport me vitin 2013. Mos realizimi i shitjeve të ujit, para së gjithash është rezultat i jo efikasitetit të KRU për ti rritur shitjet sasiore, por një pjesë mund ti atribuohet edhe zvogëlimit të prodhimit i cili në vitin e shqyrtuar ka qenë më i ultë për 2%, se sa në vitin paraprak 2013.

Performanca e shitjeve në nivel të kompanive, në rastin me të mirë është ajo e KRU 'Bifurkacion' me përqindjen me të lartë të caktuar të arritur (88%). Po ashtu arritja e planifikimeve nga kjo kompani është më mirë për 5 %, krahasuar me vitin 2013, për tu pasuar edhe nga KRU 'Hidrodrini', me arritëshmeri të caktuar 85% dhe progres prej 4%. KRU 'Mitrovica', si rast me i keq, ka arritur vetëm 69% të caktuar të synuar. Për më tepër performanca e kësaj kompanie në këtë tregues është me e ultë për 4% nga viti paraprak 2013 edhe pse gjatë vitit 2014, është raportuar rritje të prodhimit.

#### Vlera e shitjeve relative e të furnizimit me ujë

Figura 12, pasqyron trendet e vlerës së shitjeve të realizuara, gjatë periudhës raportuese 2014, në raport me vitin 2013.

Janë vetem tri nga shtatë KRU, të cilat kanë treguar progres në këtë tregues gjatë vitit 2014. Shitjet më të larta për rreth 11.34 %, i ka realizuar KRU 'Hidrodrini', duke pasuar nga KRU 'Bifurkacioni' me 9,17%. KRU 'Prishtina', 'Hidroregjioni Jugor dhe Radoniqi', janë nënë masataren e sektorit, me rënje të vlerës së shitjeve në vitin 2014/2013. Në vlerë absolute, shitjet në 2014 në raport me vitin 2013, janë më të ulta për 2.45% në nivel të sektorit.

**Vlera relative e shitjeve të furnizimit me ujë (%) në 2014/2013**




Figura 12, Vlera e shitjeve të furnizimit me ujë gjatë 2014 në raport me vitin 2013

**Kostot për njësi**

Në këtë pjesë të raportit, janë vlerësuar dhe diskutuar, kostot në kenter të: shpenzimeve njësi të prodhimit, kostove totale për njësi e furnizimit me ujë, si dhe kostove totale për njësi e furnizimit me ujë e realizuar në raport me atë të planifikuar.

**Kostoja e Prodhimit**, Kostoja për njësi e ujit të prodhuar është tregues po ashtu i rëndësishëm financiar në bazë të cilës, vlerësohen shpenzimet operative për prodhimin e një m<sup>3</sup> të ujit.

**Kostoja për njësi të ujit të prodhuar**





Figura 13, Kostoja për njësi e ujit të prodhuar gjatë 2012 në raport me vitin 2011

Në nivel të sektorit, kostoja mesatare e një njësie uji të prodhuar në 2014, ka shënuar në terma real një rritje marginale nga 2013 në 2014 për 0.01€/m<sup>3</sup>.

Kostoja e prodhimit të ujit më e ulëta, variron nga 0.001 €/m<sup>3</sup> tek KRU 'Hidrodrini', deri tek ajo më e larta në 0.08 €/m<sup>3</sup> në KRU 'Hidroregjioni Jugor'. Kostoja e prodhimit ndikohet kryesisht nga lloji i sistemit të furnizimit, p.sh furnizimi me gravitet është më i lirë të operohet se sa sistemi me pompa po ashtu edhe burimi me cilësi të mirë të ujit të pa përpunuar, zvogëlon dukshëm koston e prodhimit, siq është rasti tek KRU 'Hidrodrini'

Kostoja e lartë e ujit të prodhuar në KRU 'Hidroregjioni Jugor', edhe këtë vit është ndikuar nga shpenzimet e larta për trajtimin e ujit në veçanti nga shpenzimet e energjisë dhe derivateve gjatë funksionimit të pompave.

**Kostoja totale për njësi e furnizimit me ujë**, paraqet shpenzimet totale, përfshirë shpenzimet operative dhe shpenzimet për mirëmbajtje kapitale të aktivitetit biznesor për furnizim me ujë por duke përjashtuar kthimin në kapital dhe borxhet e këqija, të gjitha në raport me sasin e ujit të shitur për të njëjtën periudhë raportuese.



**Figura 14, Kostoja për njësi të furnizimit me ujë, EUR për m<sup>3</sup> të ujit të shitur**

Kostoja për njësi e furnizimit me ujë në nivel të sektorit në vitin 2014 krahasuar me vitin 2013 ka qenë më e lartë për 0.02 €/m<sup>3</sup>.

Siç vërehet edhe nga figura me lartë, KRU 'Hidrodrini', ka nivel dukshëm më të ulët të koston nga të gjitha kompanitë tjera me 0.24 €/m<sup>3</sup>, kjo është për 100% më e ultë se në KRU 'Prishtina', me 0,50 € për m<sup>3</sup> të ujit të shitur dhe të paguar.

Kostot në vitin 2014/2013, përveç tek KRU 'Hidroregjioni Jugor, dhe 'Mitrovica', kanë treguar trende në rritje. Trendi më i shprehur në rritje sidomos është shfaqur tek KRU 'Prishtina', me një rritje prej 0.09 €/m<sup>3</sup>.

Rritja e kostove për njësi të ujit të furnizuar, mund t'i atribuohet zvogëlimit të shitjeve volumetrike, dhe rritjeve të dukshme të shpenzimeve totale operative të shërbimeve të ujit si në nivel mesatar të sektorit e po ashtu edhe tek shumica e KRU. Po ashtu edhe humbjet e larta aktuale të ujit, kanë ndikim të madhë në rritjen e koston së ujit të prodhuar dhe të shitur.

**Kostoja totale për njësi e furnizimit me ujë e realizuar ne raport me atë të planifikuar**, është një tregues financiar i cili radhitet në grupin e treguesve kryesor, si i tillë ka ndikim në performancën e furnizimit me ujë. Ky tregues paraqet kostot njësi të furnizimit me ujë të realizuara në raport me kostot<sup>6</sup> e planifikuara për njësi të furnizimit me ujë.

Përbushja e kostotove të planifikuara për njësi që rrjedhin nga rishikimi tarifor 2012-2014 (të rregulluara sipas niveleve të çmimeve në 2014), tek shumica e KRU ishin më të ulta se sa ato të planifikuara, përjashtuar KRU 'Mitrovica' dhe 'Hidroregjioni Jugor'.

Në nivel të sektorit përbushja e objektivave të kostove për njësi e furnizimit me ujë në 2014, edhe më tej ka devijuar nga objektiva e planifikuar prej 90%. Norma prej 123%, ka qenë më e lartë për 14%. se sa në vitin 2013

<sup>6</sup> Kostot totale dhe kostot e planifikuar marrin, parasyshë shpenzimet operative duke përfshirë mirëmbajtjen kapitale në raport me vleren sasiore të ujit të faturuar.




Figura 15, Kostoja për njësi e furnizimit me ujë ne raport me kostot e planifikuara për njësi

Performancën më të mirë në këtë tregues e ka treguar KRU 'Mitrovica', me realizimin e kostove njësi në nivel 98%, përderisa performanca më e dobët, është treguar nga KRU 'Hidromorava' dhe 'Bifurkacioni'. Arsyeja e performancës së dobët, qëndron tek norma e lartë e shpenzimeve operative në KRU, dhe mos realizimi i investimeve kapitale si dhe shitjeve të ujit në vlerat e planifikuara, gjatë procesit tariforë. Niveli i lartë aktual i shpenzimeve operative, është për shkak të joefikasitetit operativ dhe numrit të madhë të personelit në shumicën e KRU.

### Shpenzimet kapitale për ujë

Paraqesin totalin e shpenzimeve kapitale të realizuara për mirëmbajtje dhe rritje kapitale në shërbimet e ujit në raport me shpenzimet kapitale të aprovuara në planin e biznesit. (2012-2014), për vitin 2014.




Figura 16, Shpenzimet kapitale për furnizim me ujë në raport me ato të planifikuara

Në total planifikimet e KRU për vitin 2014, si nga mjetet vetanake dhe nga mbeshtetjet e donatorëve, kanë qenë 10,6<sup>7</sup>mil.€, shumica e investimeve (8.8 mil.€) kanë qenë të planifikuara për mirëmbajtje kapitale, përderisa pjesa tjetër 1.8 ishin të planifikuara në total për rritjen kapitale. Niveli i realizimit të investimeve të projektuara në total ishte rreth 9.2 mil.€ apo 87%. Performanca e investimeve në raport me planifikimet

<sup>7</sup> Vlerat janë të rregulluara për shkallën e inflacionit

prej 87% duket të jetë me e përmirësuar se sa ishte në vitin 2013, ku niveli i investimeve të realizuara ishte 57%, mirëpo duhet pasur parasysh s planifikimi për vitin 2013, kanë qenë me ambicioze me rreth 25.7 mil.€.

% më e lartë e investimeve nga totali, kanë qenë të planifikuara nga KRU 'Prishtina', - 8,1mil.€, përderisa janë realizuar -1.5mil.€ apo 18.7%. Kompanitë e tjera, kanë paraparë vlera të vogëla të investimeve në shërbimin e furnizimit me ujë, të cilat varironin nga 0.2 deri 0.8 mil.€, apo siç ishte rasti me KRU 'Mitrovica' e cila nuk ka planifikuar asnjë investim në këtë shërbim për vitin 2014. Vihet re se shumica e niveleve të larta të investimeve të deklaruara nga KRU 'Hidromorava', dhe KRU 'Bifurkacioni', por edhe nga KRU 'Hidroregjioni Jugor', ishin shumë më të larta se sa ato të planifikuara në BPRR, të cilat ishin kryesisht investime nga donatorët (grande) se sa që ishin të financuara nga burimet vetanake financiare. Shumat e buxhetuara nga KRU, vazhdojnë të jenë, shumë më ultra se investimet e planifikuara dhe kërkesat të cilat i ka sektori. Megjithatë është inkurajuese fakti se orientimi i KRU në vitet e fundit është me dedikimin për mirembajtje kapitale. Kjo me siguri se do të rezultoj në mënyrë efektive në përmirësimin e bazës së aseteve dhe të niveleve të shërbimit. Niveli i lartë i UPF dhe frekuenca e lartë e plasjeve në rrjetë, është dëshmi se sa janë të nevojshme, shpenzimet domethënëse në mirëmbajtje kapitale brenda rrjetit.

**Tabela 3, Vlera e investimeve në shërbimin e ujit**

Realizimi i investimeve në shërbimet e ujit nga të hyrat vetanake dhe grantet për vitin 2014				
Kompania	Inv. në prodhim	Inv. në distribuim	Inv. në aktivitete biznesore	Totali
Prishtina	358,976	719,319	382,730	1,461,025
Hidroregjioni Jugor	115,803	662,442	44,885	823,130
Hidrodrini	-	436,900	300,469	737,369
Mitrovica	-	-	-	-
Radoniqi	730,285	248,949	157,955	1,137,189
Bifurkacioni	182,000	2,881,758	6,942	3,070,700
Hidromorava	1,790,769	178,240	-	1,969,009
<b>Totali</b>	<b>3,177,833</b>	<b>5,127,608</b>	<b>892,981</b>	<b>9,198,422</b>

## 3.2 Shërbimet për ujërat e zeza

### 3.2.1 Performanca teknike

Kjo pjesë e raportit, paraqet analiza dhe komente për performancën individuale të KRU, në shërbimin e ujërave të zeza, përfshirë: aspektet operative, shërbimet ndaj konsumatorëve si dhe ato financiare, në disa prej treguesve kryesorë të performancës për këtë shërbim. Meqenëse ende nuk ka filluar trajtimi i ujërave të zeza, ZRRUK edhe kete vit nuk ka patur mundësin e vlerësimit në treguesit e cilësis së ujërave të zeza të shkarkuara dhe Besueshmëris së shërbimit. Prandaj në vazhdim do të ofrohen informacione lidhur vetëm me mbulueshmërin si dhe besueshmërin e shërbimeve të kanalizimit e cila është e ndikuar nga frekuenca e dështimit të shërbimit të kanalizimeve për 100 kilometra të rrjetit kryesor.

#### **Frekuenca e bllokimit të kanalizimeve**

Paraqet, numri i incidenteve të raportuara në lidhje me bllokimet e kanalizimeve nga KRU, në periudhën raportuese të ndarë për 100 km, gjatësi të rrjetit të kanalizimit. Qëllimi i këtij treguesi është për të raportuar për numrin e bllokimeve në sistemin e kanalizimit. Një asfiksion është përcaktuar si një bllokim i konfirmuar i pjesëshëm ose total që mund të rezultojë me një derdhje nga sistemi kanalizimit në mjedisin e jashtëm. Është një tregues i rëndësishëm i shërbimit të ujërave të zeza, i lidhur në masë të madhe edhe me kënaqshmërin e konsumatorëve me shërbimin e ofruar.




Figura 17, numri i bllokimeve të kanalizimit

Figura 17, Tregon se gjatë vitit 2014, numri i bllokimeve në rrjetin e kanalizimit për 100 km gjatësi në nivel sektori është raportuar të jetë në nivel më të lartë për 19%, në raport me vitin 2013.

KRU 'Prishtina' dhe Radoniq', shënuan nivelet më të larta të bllokimeve, KRU 'Prishtina' me 1,090 përkatësisht KRU 'Radoniq' me 990 (bllokime për 100 km/kanalizimi). Në të kundërt është KRU 'Bifurkacioni', me 203 bllokime për 100 km/kanalizim) e cila krahasë KRU 'Mitrovica', në raport me vitin paraprak kanë shënuar rënje (përmirësim), në këtë tregues.

Niveli i ultë i performancës së sistemit të kanalizimit në vend, i cili si i tillë është jashtë standardeve të vendeve europiane, para së gjithash është pasojë e mungesës së mirëmbajtjes (pastrimit) më të mirë si dhe investimeve të pa mjaftueshme në sistemit e rrjetit të kanalizimit. Mungesa e një programi adekuat nga shumica e KRU, për pastrimin e rrjetit të kanalizimit ka bërë që bllokimet sa vinë e rriten vit pas viti.

Për më tepër viti 2014, pas një periudhe të thatë (gjysma e parë e vitit) është karakterizuar edhe me një valë, të reshurave intensive (gjysëm e dytë e vitit), të cilat kanë shkaktuar vërshime pothuajse në tërë vendin. Duke bërë që sistemit e kanalizimeve të dalin jashtë funksionit dhe ujërat e zeza të vërshojnë në sipërfaqe duke shkaktuar, dëme materiale sidomos në qendra urbane.

#### **Mbulueshmëria me shërbime të kanalizimit**

Mbulueshmëria me shërbime të kanalizimit të ujërave të zeza, është e definuar si përqindja e popullsisë brenda zonës së shërbimit që kanë çasje në kanalizim adekuat.




Figura 18, Mbulueshmëria me shërbimet e kanalizimit

Mbulueshmëria me shërbime të ujërave të zeza në nivel sektori ka vazhduar të rritet gradualisht dhe në 2014, arrin normën 62%, kjo do të thotë se në raport me vitin 2013, është përmirësuar për 2%.

Rritje të dukshme me mbulueshmëri të kanalizimit, është shënuar në zonën e përgjegjësisë së KRU 'Bifurkacioni', e cila për 10%, është më e lartë në vitin 2014. KRU 'Prishtina', po ashtu ka shënuar progres në vitin raportues për 5%, në raport me vitin paraprak.

Mbulueshmërinë më të ultë me shërbime të kanalizimit nga të gjitha KRU e tjera, vazhdon ta ketë KRU 'Hidrodrini', me vetëm 37%, të mbulueshmërisë në zonën e saj të përgjegjësisë.

### 3.2.2 Performanca komerciale

#### Ankesat

Ky tregues, raporton numrin e përgjithshëm të ankesave të pranuar nga KRU, prej konsumatorëve të tyre për shërbimin e kanalizimit. Është një formë e pakënaqësisë së konsumatorëve, drejtuar ofruesve të shërbimeve në formë të shkruar apo verbale. Pra, numri i ankesave është një tregues i nivelit të shërbimit të konsumatorëve dhe kënaqshmërisë së konsumatorëve me shërbimin e ofruar.

Ankesat në shërbimet e ujërave të zeza




Figura 19, Ankesat për shërbimet e ujërave të zeza

Figura 19, e ilustruar me lartë, pasqyron numrin e ankesave të regjistruara teknike dhe komerciale në total ndaj shërbimit të ujërave të zeza, Ankesat teknike, për shërbimin e ujërave të zeza kanë të bëjnë me qeshtjet operative kryesisht me bllokimet e kanalizimeve. Përdërisa ankesat e natyrës komerciale me tepër janë për shkakun e kontestimit të saktësisë së faturimit dhe mënyrës së faturimit.

Numri i ankesave të paraqitura nga ana e konsumatorëve si teknike edhe atyre komerciale për shërbimet e ujërave të zeza në nivel mesatar vendi gjatë vitit 2014, ka shënuar rënje për 32%, në raport me vitin paraprak (2013). Numri total i ankesave për shërbimet e ujërave të zeza, gjatë vitit 2014 ka qene 3,685 prej të cilave shumica apo 3,537, kanë të bëjnë me aspektet teknike, ndërsa 148 vetëm për qeshtjet komerciale. Kompania e cila nuk ka raportuar fare ankesa në shërbimet e ujërave të zeza është KRU 'Bifurkacioni', për faktin se ankesat e konsumatorëve, nuk janë azhurnuar si duhet nga ana e kësaj kompanie.

Zvoglimi i numrit të ankesave të konsumatorëve për shërbimet e kanalizimeve në 2014/2013, është në kundërshtim me vetë faktin se në vitin 2014, ka pasur një numër më të madhe të incidenteve (bllokimeve) të kanalizimit, me tepër kjo rënje, reflektohet nga arsyeja e mos përditesimit të tyre, siç është rasti tek KRU 'Bifurkacioni'.

### 3.2.3 Performanca financiare<sup>8</sup>

Në këtë nen-seksion, të raportit, janë vlersuar treguesit financiarë përmese të cilëve është pasqyruar qëndrueshmëria financiare e KRU, siç janë: shitjet, kostot operative dhe kapitale për shërbimin e ujërave të zeza.

#### Vlera e shitjeve të shërbimeve të ujërave të zeza (EUR)

Figura 20, si me poshtë paraqet, performancën e shitjeve të shërbimeve të ujërave të zeza, në krahasim me vlerësimet e planifikuara ashtu siç ishin të përcaktuara në aplikacionet tarifore të KRU, në procesin tarifor 2012-2014.




Figura 20, Shitjet e shërbimeve të ujërave të zeza në raport me planifikimet

Shitjet për shërbimet e ujërave të zeza, janë të lidhura me shitjet sasiore të ujit. Për shkak të nen-performancës së konsiderueshme të shitjeve aktuale të ujit, krahasuar me shitjet e planifikuara vlera e shitjeve aktuale të shërbimeve të ujërave të zeza, gjithashtu është nën vlerat e planifikuara të shitjeve.

Siç shihet nga figura 20, asnjë nga KRU, nuk kanë mundur të arrijnë objektivat e shitjeve të ujërave të zeza, gjatë vitit 2014. Për më tepër ato janë më të ulta se sa ishin në vitin 2013, për të gjitha KRU, përjashtuar KRU 'Bifurkacionin' dhe 'Hidrodrinin'.

Përmbushja e objektivës në nivel të sektorit për 2014, ishte në nivel prej 63%, kjo është për 11% më e ultë nga ajo që ishte në vitin 2013. KRU 'Bifurkacioni', ka arritur përqindjen më të lartë të përmbushjes së objektivës së shitjeve në krahasim me vitin e kaluar krahasuar me kompanitë e tjera për 17%. Po ashtu KRU 'Hidrodrini' e ka përmirësuar normën e shitjeve të ujërave të zeza për 5%.

**Vlera relative e shitjeve të shërbimeve të kanalizimit**, janë vetëm tri kompani si KRU 'Bifurkacioni', 'Hidrodrini' dhe KRU 'Mitrovica', të cilat kanë realizuar vlerën e shitjeve të ujërave të zeza me shumë se sa në vitin 2013. KRU 'Bifurkacioni' ka realizuar shitje me të lartë për 35% duke pasuar nga KRU 'Hidrodrini' me 25%.

<sup>8</sup> Sikurse për raportimin e performancës për furnizimin me ujë të gjitha vlerat e shprehura në euro, janë të rregulluar sipas çmimeve bazë për vitin 2014.

Vlera relative e shitjeve të shërbimeve të kanalizimit gjatë 2014 në raport me 2013




Figura 21, vlera relative e shitjeve të shërbimeve të kanalizimit gjatë 2013 në raport me 2012.

Në nivel të përgjithshëm në vitin 2014, shitjet janë më të larta për 0.8% se sa ishin në vitin 2013.

KRU 'Radoniq', 'Hidromorava', 'Prishtina' dhe KRU 'Hidroregjioni Jugor', kanë vlera negative të shitjeve të cilat po ashtu, janë nën nivelin mesatarë të sektorit për shitjet e ujërave të zeza.

#### Shitjet totale për njësi e shërbimeve të ujërave të zeza të realizuara në raport me planifikimet

Kostoja totale, për njësi e shërbimeve të ujërave të zeza është një tregues financiar i cili po ashtu njëjtë sikurse të furnizimi me ujë radhitet në grupin e treguesve kryesor në bazë të të cilëve matet performanca KRU, në shërbimin e ujërave të zeza. Ky treguesi, paraqet, efikasitetin e kostos (kosto për njësi e ujit të shitur krahasuar me pritjet sipas planit të biznesit).

Niveli i përbushjes së kostove të planifikuara për njësi që rrjedhin nga rishikimi tarifor (2012-2014), Kosto për njësi më e vogël ose e barabartë me 90% ka qenë niveli i synuar.





Figura 22, Kostoja për njësi e shërbimeve të ujërave të zeza në raport me kostot e planifikuara për njësi

Performanca e treguar në figurën 22, tek të gjitha KRU ishin më të ulëta se sa ato të planifikuara, megjithatë, kjo nuk tregon efikasitet më të mirë se sa ishte planifikuar për arsye se kostot e planifikuara për njësi kanë përfshirë shpenzimet operative të cilat aktualisht kanë qenë për 23% më të larta se planifikimet, si dhe realizimi i ultë i investimeve për mirmbajtje kapitale.

### Kostoja totale për njësi për shërbimin e ujërave të zeza

Kostot për njësi të shërbimeve të ujërave të zeza janë të definuara si kosto vjetore (shpenzimet totale operative për ujëra të zeza, përfshirë mirëmbajtjen kapitale të ujërave të zeza) në raport me konsumatorët shtëpiak të shërbyer<sup>9</sup>.

Kostot për njësi për vitin 2014 dhe 2013 janë paraqitur në figurën 23.



**Figura 23, Kostoja për njësi të shërbimeve të ujërave të zeza (operativ+mirëmbajtje kapitale)**

Kostoja për njësi e shërbimeve të ujërave të zeza në nivel të sektorit në vitin 2014, krahasuar me vitin 2013 ka qenë 4.71 €/kons, duke shënuar trende në rënje, kryesisht për shkakun e mungesës së investimeve në mirëmbajtje kapitale në rrjetë në periudhën raportuese.


Kostot më të larta për njësi në shërbimet e ujërave të zeza, vazhdojnë të jenë në KRU 'Radoniqi', përderisa shpenzimet më të ulta, janë bërë në KRU 'Prishtina'.

Kosto për njësi e shërbimeve të ujërave të zeza në Kosovë, janë shumë të ulëta në krahasim me kostot e shërbimeve të ujërave të zeza në vendet europiane për shkakun e mungesës së trajtimit të ujërave të zeza.

Kjo do të jetë edhe për pak kohë duke marrë parasyshë, nevojën dhe paralajmrimet për përmirësimin e konsiderueshëm të shërbimeve të ujërave të zeza në Kosovë, e sidomos me futjen në përdorim të impianteve për trajtimin e ujërave të zeza si dhe zgjerimin e rrjetit të shërbimeve.

### Shpenzimet kapitale për ujëra të zeza

Paraqesin totalin e shpenzimeve kapitale të realizuara për mirëmbajtje dhe rritje kapitale në shërbimet e ujërave të zeza, në raport me shpenzimet kapitale të aprovuara në BPRR për vitin 2014.



**Figura 24, Shpenzimet kapitale për shërbime të ujërave të zeza në raport me ato të planifikuara në 2014**

Projeksionet e pergjithëshme të KRU për investime kapitale në shërbimin e ujërave të zeza për vitin 2014, kanë qenë në total rreth 13.4<sup>10</sup> mil.€, të cilat janë parapar të sigurohen si nga mjetet vetanake dhe donatorët., por në realitet shpenzimet e realizuara ishin shumë më të ulëta se niveli i pritur dhe atë vetëm 0.355 mil.€ apo 2.66%.

Në shumën e përgjithshme prej 13.4mil.€, kanë ndikuar projeksionet ambiciozee të KRU 'Hidrodrini', të cilat në total kanë qenë rrethë 11,7 mil.€. Më pak kanë, qenë të dedikuara për rehabilitimin e rrjetit të kanalizimit, përdrisa pjesa dërmuese për Impijantin e ujërave të zeza. Projeksionet e KRU 'Hidrodrinit', kanë qenë të mirëpritura nga ZRRUK, edhe për faktin se shërbimet e ujërave të zeza (kanalizimi) të ofruara nga kjo kompani, janë në nivelin më të ultë dhe lënë shumë për të dëshiruar. Realizimi i projeksioneve në vitin 2014, nga kjo kompani ishin në nivelin prej më pak se 1%. KRU 'Prishtina' dhe 'Hidroregjioni Jugor', prijnë me realizimin e investimeve kapitale në shërbimin e ujërave të zeza me nivelin 37%, (Prishtina), përkatësisht 30.1% (Hidroregjioni Jugor) nga të gjitha kompanitë e tjera përderisa KRU 'Mitrovica', nuk ka realizuar asnjë investim, ndonëse nuk ka parapar asnjë investim në këtë shërbim.

Është dëshperuese se edhe për kundër kërkesave të mëdha për investime të cilat i ka ky shërbim, shumat e buxhetuara si nga KRU e po ashtu edhe Agjencionet zhvillimore në vendë, vazhdojnë të jenë shumë minore në raport me kërkesat.

**Tabela 4, Vlera e investimeve në shërbimin e ujërave të zeza**

Realizimi i investimeve në shërbimet e ujërave të zeza nga të hyrat vetanake dhe grantet për vitin 2014


KRU	Inv.në grumbullim	Inv.në trajtim	inv.në shkarkim	inv.akt. biznesore	Totali
Prishtina	130,559.00	0.00	-	9,748.00	140,307.00
Hidroregjioni Jugor	0.00	86,003.19	-	4,987.00	90,990.19
Hidrodrini	35,599.00	0.00	-	33,385.00	68,984.00
Mitrovica	0.00	0.00	-	0.00	0.00
Radoniqi	0.00	0.00	-	35,889.00	35,889.00
Bifurkacioni	5,222.80	0.00	-	858.00	6,080.80
Hidromorava	0.00	0.00	-	13,644.36	13,644.36
<b>Totali</b>	<b>171,381</b>	<b>86,003</b>	<b>-</b>	<b>98,511</b>	<b>355,895</b>

<sup>10</sup> Te dhenat jane rregullaur per shkallen e Inflacionit

### 3.3 Performanca financiare e KRU

#### Arkëtimi i të ardhurave

Paraqet proporcionin e shumës së arkëtuar në raport me totalin e shumës së faturuar. Llogaritja merr në konsiderat vetëm faturimin për shërbimet e ujit dhe kanalizimit, (tarifën fikse, volumetrike të ujit dhe të ujërave të zeza). Pra, këtu nuk janë përfshirë të hyrat e tjera që kompanitë kanë mundur të kenë. Ky është njëri prej treguesve më domethënës i cili krahas reduktimeve të humbjeve të ujit, ka impaktë të drejtpërdrejtë në qëndrueshmërinë financiare të një kompanie.



**Figura 25, Efiçienca në arkëtimin e të ardhurave**

Figura 25, Pasqyron efikasitetin individual të KRU në mbledhjen e të ardhurave për shërbimet e ofruara. Në vitin 2014, kemi një përmirësim me të theksuar të efiçencës së arkëtimin të borxheve për shërbimet e furnizimit me ujë dhe të kanalizimit. Në mesatare të sektorit, përmirësimi është për 3%. Kjo do të thotë se shkalla e arkëtimin në mesatare të sektorit në vitin 2014, ka arritur nivelin prej 74%. Në vitin 2014, të gjitha KRU, kanë shënuar trend pozitiv në treguesin e shkallës së arkëtimin, përveç KRU 'Mitrovica', e cila ka treguar performancë të njëjtë (48%) me vitin 2013. Edhe pse në vitin 2014, progresin më të mirë krahasuar me vitin 2013 në shkallën e arkëtimin duket se e kanë arritur KRU "Radoniqi" me 8%, KRU 'Prishtina', me 4% dhe si dhe KRU 'Hidroregjioni jugor', me 3%. Kjo është me tepër për shkakun se realizimi i shitjeve të ujit në keto tri kompani, kanë qenë shumë më të ulta se sa në vitin 2014, po ashtu edhe vlera e arkëtuar (keshi) është dukshëm më e ultë në këto KRU se sa një vit më parë.

Objektivat e përcaktuara me proceset rregulatore (tarifore) edhe këtë vit nuk kanë mundur të arrihen. Në nivel të sektorit, devijimi është vetëm prej 1% nga norma e planifikuar prej 76%.


Edhe pse, përmirësimi është gradual, efiçienca në shkallën e arkëtimin nga konsumatorët shtëpiak mbetet ende sfidë për të gjitha KRU. Nën-performanca komerciale e përgjithshme e ultë dhe mos arritja e objektivave në arkëtimin e të ardhurave dhe shitjeve siq ishte planifikuar, ka bërë që paraja e pritshme e gatshme në disponim për investime, praktikisht të mungojë. Ky ka qenë edhe shkak kryesor i dështimit për të përmbushur, objektivat e investimeve të planifikuara nga mjetete vetanake të KRU.

Në vitin 2014, është vërejtur një përkushtim me i madhë nga të gjitha KRU, në ngritjen e efiçencës së mbledhjes së të ardhurave për shërbimet e ofruara. Ndërmarrja e masave operative (shkqçjeve) si dhe procedimi i lëndeve përmes përmbauesve privat, duket se ka sjellë rezultate.

### Kthimi në kapital

Është e definuar si kthimi në bazën rregullatore të asetëve i paraqitur si të ardhura vjetore dhe rritje e kapitalit nga investimet e shprehura si përqindje e investimit origjinal. Në procesin tarifor 2012–2014, kem përvetsuar një vlerë të vërtetë të kthimit (pas inflacionit) prej 5.3%, në bazën rregullatore të asetëve (BRA).

Kthimi në kapital është i nevojshëm për të siguruar besimin e investitorëve në sektorë, nëse kompanitë duan që të tërheqin financime për përmirësimin e asetëve në mënyrë që të përmbushin përmirësimin e nevojshëm të nivelit të shërbimit. Norma reale e kthimit në kapital është e bazuar në praktikat e mira të vendeve të Europës Perëndimore.



**Figura 26, Kthimi në bazën rregullatore të asetëve (BRA)**

Kthimi në kapital në nivel të sektori është negativ për vleren 1.63% duke shënuar përkeqësim në vitin 2014 në raport me vitin 2013 kur ai ishte pozitiv. Vetëm dy KRU (Hidrodrini dhe Radoniqi), kanë pasur kthime pozitive, edhe pse kthimi në kapital është shumë më i ultë se sa ai i planifikuar prej 5.30%. Për dallim nga viti i kaluar tek KRU 'Mitrovica', kishte përmirësim ndonëse kthimi ende është negativ. Përkunder kësaj KRU e tjera (Hidromorava, Hidroregjioni Jugor, Prishtina dhe Bifurkacioni), kanë shënuar trende negative për më tepër kjo do të thotë se ato nuk arritën dukshëm të mbajnë shpenzimet e tyre, përfshirë zhvlerësimin sipas kostos aktuale dhe mirëmbajtjen infrastrukturore në BRRA, brenda të të ardhurave të tyre.

### 3.4 Performanca e përgjithshme e KRU

#### Arsyeshmëria

Monitorimi i Performances dhe vlerësimi krahasues (Benchmarking) është thelbësor për zhvillimin dhe zbatimin e politikave që kanë qëllim përmirësimin e shërbimit nga ofruesit e shërbimeve të ujit. Nëse një vendimmarrës nuk e dinë se ku kanë qenë dhe ku janë ata, kjo do të duket të jetë e pamundur për të vendosur objektiva të arsyeshme për ecurinë e ardhshme. Informacionet për KRU për aspektet operative, financiare dhe të shërbimeve ndaj konsumatorëve janë të rëndësishme për menaxhim dhe mbikëqyrje të mirë. Korniza e raportimit dhe metodologjia e vlerësimit të performancës nga ZRRUK, kërkon nga KRU raportimin e të dhënave për nevojat e kerkesave rregullatore të cilat në fokus kanë përfitime për konsumatorët. Përderisa vlerësimi i performancës, bënë matjen dhe krahasimet ne rrafshet vijuese:

- (i) Performancës relative ndaj 'premtimeve' të biznes planit, (krahasimi i performancës kundrejt propozimeve/caqeve tarifore),
- (ii) Performancës absolute relative ndaj pritjeve ideale të performancës,
- (iii) Performancës relative krahasuese në mes KRU dhe kundrejt performancave të viteve të kaluara, si dhe
- (iv) Performancës së sektorit, (informacione për Politik-bërsitë dhe Donatorët, etj.)

Korniza e raportimit të performancës (të dhënat, treguesit dhe definicionet), janë harmonizuar me mjetet e tjera rregullatore (Biznes planet e Kompanive, Llogarit rregullatore, Procesin Tarifor, Standardet e shërbimit) të përdorura të cilat kanë qenë të nevojshme për të matur performancën jo vetëm kundrejt viteve të kaluara, por që është më e rëndësishme, kundrejt caqeve të dakorduara të performancës në aplikacionet tarifore.

#### Vlerësimi i performancës

Vlerësimi i performancës së KRU, është bërë në bazë të 11, Treguesve Kyq të Performancës, të cilët i përmbushin kriteret e të qenit të rëndësishëm, reflektojnë besueshmërinë e shërbimit, si dhe promovojnë efijencën financiare në të dy shërbimet: Furnizimi me ujë dhe Shërbime të ujërave të zeza. Vlerësimi i performancës është në përputhje me praktikat e mira ndërkombëtare që janë në zbatim nga rregullatorët e këtij sektori, ku në fokus janë kërkesat specifike rregullatore, në nivele të veçanta të shërbimeve dhe të implikimeve të kostos për konsumatorin. Në përdorim pra, është vendosur koncepti i vlerësimit të performancës ndaj kompanisë e cila funksionon mirë dhe ofron shërbime efijente (Performanca ideale) në; Furnizimin me ujë dhe Shërbime të ujërave të zeza, mbi bazën e cilësisë së ujit, niveleve të shërbimit, mbulueshmërisë si dhe efijencës komerciale dhe financiare.

Kriteret për matjen e performancës së furnizimit me ujë dhe shërbimeve të ujërave të zeza, janë të atilla që poentimi prej 100% reflekton ofrimin e një niveli të tillë të shërbimit të krahasueshëm me performancën e ofruesit modern mirë funksionues të furnizimit me ujë apo shërbime të ujërave të zeza.

Duke u bazuar në rezultatet e performancës së demonstruar në vitin 2014, ZRRUK ka bërë vlersimin dhe rangimin e KRU-ve. Në tri aspekte: Furnizim me ujë, Shërbime të ujërave të zeza dhe performancën e përgjithshme të KRU. Referencë kryesore e përdorur për renditjen e performancës të kompanive është performanca e tyre në raport me përmbushjen e objektivave të performancës së synuar ideale.

#### 3.4.1 Shërbimet e furnizimit me ujë

Vlerësimi i performancës si dhe rangimi i KRU, në shërbimin e furnizimit me ujë, është bërë përmes (5) pesë, Treguesve Kyq të Performancës.

- (i) **Mbulueshmëria me shërbime**, duke synuar mbulueshmëri complete (100%) në zonën respektive të shërbimit

- (ii) **Cilësia e ujit të furnizuar**, e cila është 100% në pajtueshmëri me standardet e specifikuar vendore;
- (iii) **Presioni i ujit**, brenda referencave ligjore vendore me nivelet e specifikuar minimale (25 m.sh.u) dhe maksimale (70 m.sh.u);
- (iv) **Disponueshmëria e furnizimit me ujë**, uji për të gjithë konsumatorët në baza të vazhdueshme për 24h në ditë;
- (v) **Efiçenca e kostos**, kosto efiçente për njësi e ujit të shitur dhe në përputhje me pritjet sipas planit të biznesit.

Performanca e përgjithshme e furnizimit me ujë




Figura 27, Paraqet rezultatet në vlerësimin e performancës së furnizimit me ujë si dhe rangimin e KRU

Në përgjithësi niveli mesatar i performancës së furnizimit me ujë në 2014, është në nivelin 34.6%. Kjo është më e ultë për 2.13%, se ajo e vitit paraprak (36.7%). Niveli i treguar në vitin 2014 është për 10.4% nga maksimumi prej 45%, aq sa është peshuar performanca e furnizimit me ujë.

Treguesit e standardeve të shërbimit kryesisht janë, të qëndrueshëm, ndonëse ende janë në nivel, jo të kënaqshëm. Pak përmirësime, janë treguar tek mbulueshmëria me shërbime dhe presioni në rrjetë. Në dy treguesit tjerë: Cilësia e ujit ( 0.13%) dhe vazhdimësia e furnizimit (0.82%), është shënuar përkeqësim.

Performanca financiare e furnizimit me ujë e përfaqësuar me efiçencën e kostove, pa dallim në të gjitha KRU, është më e dobët, për 4.3% në vitin 2014 në raport me vitin 2013. Kjo do të thotë se asnjë nga KRU, nuk kanë arritur ti pëmbushin projeksionet e reduktimit të shpenzimeve operative dhe rritjes së investimeve kapitale në raport me shitjet e ujit, ashtu siq ishin të dakorduara dhe të aprovuara nga rregullatori në BPRR (2012-2014).

Tabela 5, Rezultatet për performancën e përgjithëshme të furnizimit me ujë në vitin 2013

KRU	Cilsia e Ujit	Presioni	V. Furnizimit	Mbulueshmeria	Efic.e kostove	Totali
GJA	30%	5%	35%	20%	6.04%	43.02%
PE	29%	5%	35%	18%	4.02%	40.92%
GJI	30%	5%	35%	13%	6.25%	39.65%
PZ	29%	5%	34%	13%	3.08%	37.91%
PR	30%	5%	15%	19	5.53%	33.39%
			%			
FE	29%	5%	19%	16%	1.85%	32.14%
MIT	29%	4%	15%	13%	5.20%	30.11%
Ideal	30%	5%	35%	20%	10.00%	45.00%
Sektori-Realizimi	29.5%	4.8%	26.9%	15.9%	4.6%	36.7%

Tabela 6, Rezultatet për performancën e përgjithëshme të furnizimit me ujë në vitin 2014

KRU	Cilsis e Ujit	Presioni	V Furnizimit	Mbulueshmeria	Efic.e kostove	Totali	Ndryshimi 2013/2014
GJA	30%	5%	34% <sup>11</sup>	19%	0.40%	39.9%	-3.1%
PE	29%	5%	35%	18%	0.23%	39.4%	-1.5%
PZ	27%	5%	35%	13%	0.36%	36.1%	-1.8 %
FE	30%	5%	23%	17%	0.00%	33.8%	1.7%
MIT	30%	5%	24%	13%	0.76%	32.5%	2.4%
GJI	30%	5%	20%	13%	0.00%	30.8%	-8.9%
PR	30%	5%	11%	20%	0.13%	29.7%	-3.7%
Ideal	30%	5%	35%	20%	10%	45.0%	
Sektori	29.3%	5.0%	26.0%	16.3%	0.3%	34.6%	
Ndryshimi 2013/2014	-0.13%	0.14%	-0.82%	0.38%	-4.30%	-2.13%	- 10.4%

Të gjitha KRU, përjashtuar (Mitrovicën dhe Bifurkacionin) kanë treguar performancë më të dobët në vitin raportues. Performanca më e dobët është treguar nga KRU 'Hidromorava' dhe 'Prishtina', përveçë mungesës së eficientes së kostove, ka qenë vazhdimësia e furnizimit ajo e cila ka ndikuar në mënyrë të dukshme në përqendrimin e mëtejme të furnizimit në këto dy kompani, kryesisht si pasojë e thatësisë e cila ka mbretëruar në vendë. KRU 'Mitrovica' dhe 'Bifurkacioni', kanë treguar përmirësim, kryesisht në standardet e shërbimit. Ka qenë vazhdimësia e furnizimit ajo e cila është përmirësuar në mënyrë të dukshme në këto dy kompani. Në KRU 'Mitrovica', situata e furnizimit me ujë është përmirësuar më hyrjen në funksionin të fabrikës së re e cila ka shtuar, kapacitetin e saja prodhuese, menaxhmenti i kësaj kompanie duhet pasur në konsideratë eficienten e kostove e cila në këtë kompani është shumë më e ultë se ajo e vitit-2013.

<sup>11</sup> Hjezimet e vlerave numerike në tabela me ngjyrë të kuqe tregojnë, performancë më të dobët në vitin 2014 në raport me vitin 2013.

### 3.4.2 Shërbimet për ujërat e zeza

Vlerësimi i performancës së KRU, në shërbimin e ujërave të zeza, është parapar të bëhet përmes (4) katër, Treguesve Kryesor të performancës,

- (i) **Mbulueshmërisë me shërbime për ujëra të zeza**, për qëllime të raportimit të performancës vlerë prej 95% e konsiderohet si një pritje ideale;
- (ii) **Cilësi e ujërave të zeza të shkarkuara**<sup>12</sup>, në pajtueshmëri me vlerë prej 100% me standardet e specifikuar mjedisore;
- (iii) **Besueshmëri e shërbimeve për ujëra të zeza**, me zero shtëpi të prekura nga vërshimet e kanalizimeve;
- (iv) **Efiçenca e kostos**, kosto efiçente për njësi të shërbimeve për ujëra të zeza për amvisëri.

Performanca e përgjithshme e shërbimeve të ujërave të zeza




Figura 28, paraqet rezultatet në vlerësimin e performancës së shërbimeve të ujërave të zeza si dhe rangimin e KRU

Edhe këtë vitë, ZRRUK, nuk ka pasur mundësi të bëjë vlerësimin e performancës në dy nga katër treguesit e shërbimeve të ujërave të zeza të lidhura me trajtimin e ujërave të zeza. Dy nga standardet e rëndësishme të cilat kanë, impaktë të rëndësishme në mjedisin jetësorë. Në përgjithësi në vitin 2014/2013, është shënuar shumë pak përmirësim (0.3%), të lidhura kryesisht me mbulueshmërin me shërbime të kanalizimit. Niveli i përgjithshëm i performancës, është vetem 12.1%. pra KRU, kanë hapsirë shumë të madhe për përmirësim (22.9%), për të arritur deri tek niveli i synuar prej 35% në këtë shërbim.

Spektori ka mbetur mbrapa me performancën edhe për faktin se KRU, Institucionet vendore si dhe Agjencionet zhvillimore, kanë ofruar mbështetje të kufizuar financiare për zhvillimin e mirfillt të këtij shërbimi.

<sup>12</sup>Në treguesit cilësia e shkarkimit dhe besueshmëria e shërbimit të trajtimit të ujërave të zeza. ende nuk mund të bëjmë vlerësim meqenëse nuk ka trajtim të Ujërave të zeza.

Tabela 7, Rezultatet për performancën e përgjithëshme në shërbimin e ujërave të zeza në vitin 2013

KRU	Cilësia e shkar.	Besueshmëria	Mbulueshmëria	Efic. e kost.	Totali
FE	0.0%	0.0%	37.49%	6.58%	15.43%
PR	0.0%	0.0%	38.88%	3.67%	14.89%
PZ	0.0%	0.0%	28.15%	4.75%	11.52%
GJA	0.0%	0.0%	26.80%	5.25%	11.22%
GJI	0.0%	0.0%	23.92%	6.00%	10.47%
MIT	0.0%	0.0%	24.32%	2.92%	9.53%
PE	0.0%	0.0%	20.58%	5.83%	9.24%
Ideal	20.0%	20.0%	50.00%	10.00%	35.00%
Sektori	0.0%	0.0%	28.6%	5.0%	11.8%

Tabela 8, Rezultatet për performancën e përgjithëshme në shërbimin e ujërave të zeza në vitin 2014

KRU	Cilësia e shkar.	Besueshmëria	Mbulueshmëria	Efic. e kost.	Totali	Ndryshimi 2013/2014-
FE	0.0%	0.0%	42.3%	4.0%	16.19%	0.8%
PR	0.0%	0.0%	41.6%	4.7%	16.18%	1.3%
PZ	0.0%	0.0%	28.1%	8.5%	12.82%	1.3%
GJA	0.0%	0.0%	25.8%	4.3%	10.51%	-0.7%
GJI	0.0%	0.0%	24.7%	5.2%	10.46%	0.0%
MIT	0.0%	0.0%	25.0%	4.0%	10.15%	0.6%
PE	0.0%	0.0%	18.7%	4.4%	8.10%	-1.1%
Ideal	20.0%	20.0%	50.0%	10.0%	35.00%	20.0%
Sektori	0.0%	0.0%	29.5%	5.0%	12.1%	
Ndryshimi 2013/2014-	0.0%	0.0%	0.9%	0.0%	0.3%	-22.9%

Efiçenca e kostove, në nivelin mesatar ka mbetur e njëjtë sikur në vitin 2013 me 5%, me disa ndryshime negative në performancën e treguar prej KRU (Bifurkacioni, Radoniqi, Hidromorava, Hidrodriini). Në raport me vitin 2013, vetëm dy KRU (Radoniqi dhe Hidrodriini), kanë treguar trende negative të performancës.

Rangimi i KRU në performancën individuale në 2014, ka mbetur i njëjta sikur një vit më parë. KRU 'Bifurkacioni', kryeson me performancën më të mirë nga të gjitha kompanitë e tjera, pasuar nga KRU 'Prishtina'. Mbulueshmëria me shërbime të ujërave të zeza, është në nivel më të lartë përderisa efiçenca e kostove është e ultë në këto dy kompani.

KRU 'Hidrodriini', vazhdon të ketë performancën më të dobët në shërbimin e ujërave të zeza pa shënuar ndonjë përmirësim përgjatë këtyre dy viteve. Mbulueshmëria me shërbime të kanalizimit është në nivel të ultë, e percjellur me kosto jo efiçente.

### 3.4.3 Performanca e përgjithshme e KRU

Performanca e përgjithshme nuk bazohet në performancën krahasuese të njëri-tjetrit, por bëhet një krahasim në lidhje me nivelin 'ideal' të performancës së pritshme të kompanisë që funksionon mirë dhe ofron furnizim eficient me ujë dhe shërbime për ujëra të zeza dhe paraqet kombinimin e rezultateve nga tri kategoritë e biznesit të kompanisë, dmth:

- (i) Performanca e furnizimit me ujë;
- (ii) Performanca e shërbimeve për ujëra të zeza si dhe
- (iii) Performanca e përgjithshme e biznesit për ujë dhe ujëra të zeza (efiçenca financiare).

Rezultatet e vlerësimit si dhe rangimi i KRU në performancën e përgjithshme, janë paraqitur në formë tabelare si dhe janë ilustruar në formë grafike.




Figura 29, paraqet rezultatet në vlerësimin e përfundimit të përgjithshme të KRU

Performanca e përgjithshme e KRU, në vitin 2014, është më e ultë për 4.9% kjo d.th se niveli i përgjithshëm i performancës ka rënë nga 55.1% për 2013, në 50.2% në 2014. Është shërbimi i furnizimit me ujë dhe treguesi i profitabiliteti ku KRU kanë treguar performacë më të dobët. Përderisa tek furnizimi me ujë, kemi diskutuar më herët në raport se janë: Cilësia e ujit, vazhdimësia e furnizimit e sidomos efiçenca e kostove, ku është shënuar përkeqësim, tani në performancën e përgjithshme të KRU, është profitabiliteti i cili ka shënuar rënje më të madhe për 3.9%, në raport me vitin 2013, ndonëse edhe në vitin 2014, në këtë tregues kanë arritur të mbledhin vetem 0.6%. Janë vetëm dy KRU 'Radoniqi' dhe 'Hidrodrini', të cilat kanë realizuar kthimin pozitiv në BRR. Në përgjithësi performanca e përgjithshme e KRU nuk është në nivel të kënaqshëm, aktualisht është në normën rreth 50% e performancës së synuar.

Efiçenca e arkëtimit ka shënuar përmirësim në të gjitha KRU, norma e përmirësimit në vitin 2014, është për 0.8% në raport me vitin 2013. Vlenë të theksohet se edhe pse në këtë tregues ka përmirësim, kjo më tepër i atribuohet uljes së vlerës së faturimit se sa është normë reale e përmirësuar, sidomos kjo është vërejtur tek KRU 'Prishtina', 'Hidroregjioni Jugor', 'Radoniqi' dhe KRU 'Hidromorava'. Rritje efektive të normës së arkëtimit, kanë shënuar KRU 'Bifurkacioni', 'Hidrodrini' dhe KRU 'Mitrovica'.

Tabela 9, Rezultatet për performancën e përgjithshme të KRU në vitin 2013

KRU	Furnizimi me Ujë	Ujëra të Zeza	Profitabiliteti	Arkëtimi	Totali i pikëve
Ideale	45%	35%	10%	10%	100%
GJA	43.0%	11.2%	10.0%	3.8%	68.0%
GJI	39.6%	10.5%	10.0%	2.5%	62.6%
PR	33.4%	14.9%	5.5%	4.0%	57.8%
PZ	37.9%	11.5%	2.6%	3.1%	55.1%
FE	32.1%	15.4%	3.9%	0.0%	51.5%
PE	40.9%	9.2%	0.0%	1.1%	51.3%
MIT	30.1%	9.5%	0.0%	0.0%	39.6%
Sektori	36.7%	11.8%	4.6%	2.1%	55.1%

Tabela 10, Rezultatet për performancën e përgjithshme të KRU në vitin 2014

KRU	Furnizimi me Ujë	Ujëra të Zeza	Profitabiliteti	Arkëtimi	Totali i pikëve	Ndryshimi 2014/2013
Ideale	45%	35%	10%	10%	100%	
GJA	39.9%	10.5%	0.5%	5.7%	56.6%	-11.4%
PE	39.4%	8.1%	3.9%	1.9%	53.3%	2.0%
PZ	36.1%	12.8%	0.0%	3.9%	52.8%	-2.3%
FE	33.8%	16.2%	0.0%	0.9%	50.9%	-0.6%
PR	29.7%	16.2%	0.0%	4.9%	50.8%	-7.0%
GJI	30.8%	10.5%	0.0%	3.1%	44.3%	-18.3%
MIT	32.5%	10.1%	0.0%	0.0%	42.7%	3.0%
Sektori	34.6%	12.1%	0.6%	2.9%	50.2%	
Ndryshimi 2014/2013	-2.1%	0.3%	-3.9%	0.8%	-4.9%	-49.8%

Janë vetëm dy KRU 'Hidrodrini' dhe 'Mitrovica' të cilat kanë realizuar performancë të përgjithshme pozitive, përderisa tek kompanitë e tjera, performanca e tyre është përkeqësuar në raport me vitin 2013 si dhe në raport me performancën e synuar ideale.

Edhe në vitin 2014, KRU 'Radoniqi', është kompania me performancën më të mirë e cila ka mbledhur në total 56.6% të pikëve, ndonëse performanca e sajë, është për 11.4% më e dobët. Janë tri fusha ku KRU 'Radoniqi', ka treguar trende negative të performancës (furnizimi me ujë, ujëra të zeza dhe sidomos në profitabilitet).

KRU 'Mitrovica', është kompania e cila ka treguar, përmirësim të performancës në vitin 2014, në raport me vitin 2013, fusha e përmirësimit është furnizimi me ujë dhe shërbimi i ujërave të zeza. Aktualisht kjo kompani ka mbledhur 42.7% të pikëve dhe performanca e sajë është përmirësuar në 2014 për 3%, në raport me vitin paraprak 2013.

Performanca më e dobët në 2014, është shënuar nga KRU 'Hidromorava', duke shënuar rënje të madhe në furnizimin me ujë dhe treguesin e profitabilitetit.

## Pjesa B:

# Performanca e Sektorit të Shërbimeve të Ujësjetës-Kanalizimit

---

## 4 PERFORMANCA E SEKTORIT

Në këtë pjesë të raportit është vlerësuar, performanca e sektorit për një periudhë 3 vjeçare. Ky është një moment i volitshëm për të vlerësuar të arriturat e sektorit në disa prej tregusve të rëndësishëm të lidhura me procesin tarifor trevjeçarë (2012-2014). Pra, një rafshë i rëndësishëm i diskutimit të arritave në raport me objektivat në BPRR, përgjatë kësaj periudhe.

### 4.1 Uji i prodhuar, shitjet dhe uji i pa-faturuar

Në figurën 30, janë dhënë informacione për vlerat sasiore për ujin e prodhuar, të shitur si dhe ujin e pa faturuar në total.




Figura 30, Prodhimi i ujit, shitjet dhe uji i pa-faturuar

**Prodhimi i ujit**, gjatë tri viteve të fundit të analizuar 2012 - 2014, ka shënuar rënje. Nga të gjitha KRU në vitin 2014, janë prodhuar dhe distribuar tek konsumatorët mbi 131 mil.m<sup>3</sup>, ujë të pijshëm e cila vlerë nëse krahasohet me vitin 2012, është për 5% më pakë prodhim. Për më tepër kjo është për 10%, më e ultë se sa planifikimet e KRU, prej 146.7 mil.m<sup>3</sup>, për vitin 2014 e projektuar për të percjellur rritjen e synuar të bazës së konsumatorëve si dhe përmirësimin e vazhdimësisë së furnizimit.

Një prej shkaqeve të rënjes së prodhimit, ishte edhe thatësia e cila ka mbretuar herë pas here gjatë kësaj periudhe vlerësuese. Situatë gati emergjente ka ndodhur në KRU (Prishtina dhe Hidromorava), meqenëse kanë pasur deficit të konsiderueshëm në përbushjen e kërkesave të konsumatorëve për ujë. Në gjysmëvjetorin e parë të vitin 2014, këto dy KRU u detyruan për shkakë të thatësisë të ndërmarrin reduktime shtesë të furnizimit me ujë përgjatë, gjithë zonës e tyre të shërbimit. Kjo është bërë me qëllim të shfrytimit racional të burimeve ujore. Uji i prodhuar dhe i shitur po ashtu edhe tek KRU 'Radoniqit', kanë shënuar rënje e cila para se gjithash ka ardhur për shkak të eliminimit të defekteve, përmirësimi në leximin e ujmëmatësve si dhe evidentimit të lidhjeve ilegale.

Janë tri KRU 'Mitrovica', me 2.6mil.m<sup>3</sup>, 'Hidrodrini', me 1.3mil.m<sup>3</sup> dhe 'Bifurkacioni', të cilat kanë rritur vlerat sasiore të prodhimit të ujit.

**Shitjet e ujit**, në vazhdimësi kanë dështuar të përmirësohen dhe në vitin e fundit 2014, për më tepër kanë shënuar trendë në rënje. Aktualisht nga sasia prej 131 mil.m<sup>3</sup>, ujë të pijshëm dhe të distribuar, vetëm 55.8mil.m<sup>3</sup>, ka mundur të ju faturohet konsumatorëve, kjo është për 16% me pakë se sasia e synuar prej 66.6 mil.m<sup>3</sup>, uji i shitur në fund të procesit tarifor (2012-2014).

**Uji i Pa Faturuar**, gjatë vitit 2014 në mesatare të sektorit, qëndron në nivelin prej 57.6%, apo në vlerë sasiore kjo vlerë është 75.9 mil m<sup>3</sup>, ndërsa nëse bëjmë krahasim me vitin 2013, ka një përkeqësim për 0.6%. Vetëm KRU 'Prishtina', ka mbi 18.4 mil.m<sup>3</sup> UPF, nga prodhimi i saj vjetor prej 37.5 mil.m<sup>3</sup>.

Humbja e të ardhurave për shkak të ujit të humbur, përmes rrjedhjeve, lidhje të paligjshme, ujëmatësve jo funksional ose konsumit të paregjistruar, vazhdon të jetë një shqetësim për sektorin. Rreth 76.0 mil. m<sup>3</sup>, është Uji i pa faturuar apo ujë i cili nuk sjellë të ardhura për kompaninë, përkundrazi ka shkaktuar, shpenzime për prodhimin dhe distribuimin e tij. Kjo në një masë të konsiderueshme është bërë për shkak të infrastrukturës së rrënuar dhe të matjes së ulët. Prandaj konsiderojmë se janë dy fusha, ku nga KRU, kërkohet rritja e investimeve kapitale për ta kthyer performancën e duhur të rrjeti distributiv.

Pavarësisht nga planifikimet e ulëta për ripërteritje infrastrukturore në procesin e rishikimit tarifor 2012-2014, të cilat ne besonim se do të kishin ndikuar në reduktimin e UPF, fatkeqësisht shpenzimet e realizuara për ripërteritjen dhe mirmbajtjen e infrastrukturës për periudhën 2012 - 2014 nga të gjitha KRU ishin të ulta, prandaj ne nuk jemi të befusuar që UPF, nuk është reduktuar.

Shpresojmë se një progres do të ndodhë në të ardhmën nëse KRU, janë më të përkushtuara në zbatimin e projeksioneve të tyre të shpenzimeve investive ashtu siq janë të paraqitura në biznes planet e tyre për periudhën 2015-2017 si dhe duke adoptuar një çasje më strategjike për të reduktuar UPF, në të kundërtën deri atëher situata veq se do të përkeqësohet.

## 4.2 Mbulueshmëria me shërbime

Trendet e rritjes së mbulueshmërisë për të dy aktivitetet biznesore (furnizim me ujë dhe shërbime të ujërave të zeza), janë paraqitur në figurën 31, për ndryshe mbulueshmëria me shërbime, nënkupton shkallën e mbulimit të popullatës me shërbime të ujësjellësit dhe kanalizimit nga kompanitë qendrore publike (KRU) në zonat e përgjegjës së tyre.




Figura 31, Mbulueshmëria me shërbime të ujësjellësit dhe të kanalizimit

**Mbulueshmëria me shërbime të ujësjellësit për popullsinë**, ka vazhduar trendin në rritje edhe gjatë periudhës raportuese tre vjeçare. Treguesi i mbulimit të ujit ka shënuar trend në rritje nga 78% në vitin 2012 në 84% për vitin 2014. Pra, gjatë kësaj periudhe raportuese edhe 6%, e popullatës e cila jeton në zonat e shërbimit të KRU kanë marrë furnizimin me të sigurt me ujë, nëpërmjet lidhjeve në sistemet publike të furnizimit. Gjatë tri viteve të procesit tarifor 2012- 2014, ZRRUK pati aprovuar projeksionet e KRU për rritje të bazës së konsumatorëve në baza vjetore me nga 10 000 kons. Pritjet, janë realizuar dhe aktualisht në 2014, KRU ju ofrojnë shërbime të ujësjellësit për rreth 279,000 konsumatorëve.

Përderisa në zonat urbane, mbulueshmëria me shërbime të furnizimit është e plotë, ende për një përqindje të popullatës e cila jeton në zona rurale nuk i'u është ofruar, mundësia e kyçjes në sistemet qendrore të

furnizimit me ujë. Një pjesë e konsiderueshme e popullatës që jetojnë në zona rurale, furnizimin e marrin përmes skemave të veçanta të ujësjellësve të cilat menaxhohen prej vetë komuniteteve, megjithatë ende ka një përqindje të popullatës kryesisht në zona të thella rurale të Kosovës të cila furnizohet nga burime të pasigurta (puse).

**Mbulueshmëria me shërbime të ujërave të zeza (kanalizim)**, ngjajshëm sikurse tek mbulueshmëria me ujë, përmirësim ka shënuar edhe mbulueshmëria me shërbime të kanalizimit, nga 56% për 2012 në 62% në 2014. Progresi pra, gjatë kësaj periudhe raportues (2012-2014), është rreth 6%. Projektionet e KRU, në BPRR (2012-2014) kanë qenë të ngjajshme sikurse tek furnizimi me ujë, të cilat gjithashtu, janë arritur. Duke marrë parasysh se rreth 40% e popullatës së vendit, ende presin për tu kyçur në sistemin publik të kanalizimit, sygjeron, domosdoshmërinë për më shumë fokus në këtë shërbim, duke drejtuar investimet në kanalizimet dhe për të mohuar pasojat e tij të dëmshme. Zhvillimi i ultë i shërbimit të kanalizimit dhe mungesa totale e trajtimit të ujërave të zeza, përbën një problem publik serioz dhe sfidë shëndetësore në vendin tonë, dhe në mënyrë të konsiderueshme i kontribuon, përkeqësimit në cilësinë e ujit të distribuar e sidomos të burimeve ujore. Janë, reale pritjet në këtë drejtim që vitet ardhshme të kemi edhe një përshpejtim të rritjes së mbulueshmëris me shërbime të ujësjellësit dhe kanalizimit edhe për vetë faktin se një numër investimesh me intensive, përfshirë ato të donatorëve viteve të fundit, janë orientuar në shtrirjen e rrjetit të ri të ujësjellësit dhe kanalizimit publik në fshatra të cilat ende nuk e kanë këtë shërbim. Tani më, Qeveria e Kosovës, ka hartuar një strategji për integrimin ujësjellësve rural në kuadër të KRU respektive.

### 4.3 Të ardhurat e planifikuara, qarkullimi dhe paraja e gatshme e arkëtuar

Me qarkullim në këtë rast nënkupton të hyrat nga faturimi i rregullt dhe të hyrat tjera operative për shërbime të ujit dhe ujërave të zeza.




Figura 32, Performanca financiare e sektorit

Në figura 32, është pasqyruar efikasiteti mesatar i qarkullimit dhe inkasimit, gjatë 3 viteve të fundit (2012-2014).

**Qarkullimi në vlerë monetare**, në nivelë të sektorit për shërbimet e ofruara (furnizim me ujë dhe shërbime të kanalizimit), është një fushë e cila nuk është duke u përmirësuar. Përderisa qarkullimi (faturimi) në vitin 2013/2012, në vlerë monetare është përmirësuar marginalisht për 0.6mil.€. Në vitin 2014 në raport me vitin paraprak (2013) ka shënuar rënje për 0.4 mil.€.

**Efiçenca e Arkëtimit (Keshit)**, në këto tri vite ka shënuar një ngritje të lehtë, për 1.3 mil.€ apo shprehur në përqindje për 6%. Efiçenca e arkëtimit në raport me qarkullimin në vitin 2014, ka arritur nivelin 75%. Kjo duket më e përmirësuar se sa në të vërtetë është edhe për faktin se vlera e qarkullimit ka rënë në 2014, në

raport me vitin 2013. Mëgjithatë edhe si i tillë është nivel shumë i ulët dhe jo i kënaqshëm, meqë ende ¼ e borxheve nga konsumatorët, mbetet pa u inkasuar. Të gjitha KRU, kanë rritur përpjekjet e tyre përmes aplikimit të shkycjeve dhe adresimit të mbledhjes së borxheve përmes përmbaruesve privat të cilët kanë filluar aktivitetin e tyre në vitin 2014.

**Tabela 11. Qarkullimi dhe arkëtimi sipas viteve**

Vitet	Qarkullimi	Arkëtimi/keshi	Keshi/Qarkullimin
2012	29,111,469.23	20,609,696.24	71%
2013	29,715,954.43	21,225,741.79	71%
2014	29,296,792.70	21,890,722.67	75%

#### 4.4 Shpenzimet kapitale për shërbime të furnizimit me ujë dhe ujëra të zeza

Një faktor tjetër shumë i rëndësishëm në sektor, janë investimet kapitale. Ato janë shpenzime për asetet që janë ndërtoar për të ofruar shërbime të furnizimit me ujë dhe shërbime të ujërave të zeza për konsumatorët. Në këtë seksion, kemi paraqitur pra, analizën e shpenzimeve kapitale të shtatë KRU, reale dhe ato të planifikuara përgjatë procesit tarifor (2012-2014). Nga të gjitha KRU, është pritur që të realizojnë investime të konsiderueshme në shërbimin e furnizimit me ujë dhe në shërbimin e ujërave të zeza dhe nga totali i shumës së planifikuar për periudhën trevjeçare tarifore (2012-2014), prej afro 95 mili.€, me një ndarje prej përafërsisht me 2/3 në furnizim me ujë dhe 1/3 në shërbimin e ujërave të zeza. Nga mjetet vetanake të KRU, po ashtu është planifikuar të investohen rreth 25 mil.€ shpenzime kapitale në të dy shërbimet (furnizim me ujë dhe shërbime të ujërave të zeza), pjesa tjetër nga donatorët

**Tabela 12. Investimet kapitale 2012-2014**

Vlera totale e shpenzimeve kapitale për ujë dhe ujëra të zeza			
Kompania	2012	2013	2014
KRU 'Prishtina'	5,079,692	8,989,021	1,601,332
KRU 'Hidroregjioni Jugor'	3,388,493	1,546,082	914,120
KRU 'Hidrodrini'	4,742,893	897,677	806,353
KRU 'Mitrovica'	21,851	2,052,107	0
KRU 'Radoniqi'	397,359	1,342,832	1,173,078
KRU 'Bifurkacioni'	702,392	58,209	3,076,781
KRU 'Hidromorava'	1,367,080	32,211	1,982,653
<b>Totali</b>	<b>15,699,759</b>	<b>14,918,139</b>	<b>9,554,317</b>

Vlera e investimeve, përgjate këtyre tri viteve, ka qene 40.2 mil.€, mjete të investuar, kryesisht nga donatorët, si dhe një pjesë më e vogël nga KRU. Në raport me vlerën e planifikuar realizimi i investimeve, arriti nivelin prej 42%.

Nga shuma e përgjithshme rreth 15.7, janë realizuar në KRU 'Prishtina', perderisa me pakë shpenzime kapitale, janë realizuar në KRU 'Mitrovica', në këto tri vite (2.2mil.€). Nga mjetet vetanake KRU, kanë shpenzuar për investime kapitale në vlerën, prej 5.4 mil.€, që në raport me provizionimin e planifikuar, përmes BPRR prej 25 mil.€ paraqet normën 22%.

Edhe pse ka pasur fonde të kanalizuar në drejtim të investimeve në këtë sektor, ka ende nevojë të bëhet shumë më tepër, duke pasur parasysh kërkesat e mëdha për investime. Sektori i ujit dhe ujërave të zeza ka nevojë për mbështetje të metejme investuese dhe përpjekje të bashkërenduara nga aktorë të ndryshëm.

## Pjesa C

# Performanca e Furnizuesit të Ujit me Shumicë

## 5 PERFORMANCA E FURNIZUESIT TË UJIT ME SHUMICË

ZRRUK, është përgjegjës për rregullimin e pjesës së afarizmit të NHE 'Iber Lepenci', e cila ka të bëjë me furnizimin e ujit me shumicë për KRU 'Mitrovica' dhe KRU 'Prishtina'. Në vazhdim janë dhënë të dhënat statistikore dhe disa tregues të performancës për të parë trendet e zhvillimit të performancës së NHE 'Iber Lepenci', në vitin 2014.

**Tabela 13, Të dhënat statistikore për NHE 'Iber-Lepenc'**

Të dhënat statistikore për 2013 / 2014	2013	2014
Vëllimi ujit me shumicë të faturuar (m <sup>3</sup> )	17,817,840	19,288,948
Faturimi për ujin me shumicë (€)	383,399	547,657
Arkëtimi për ujin me shumicë (€)	100,934	817,770
Kostoja e operimit për furnizimin e ujit me shumicë (€)	358,495	466,258
Numri i punëtorëve të angazhuar në furnizimin e ujit me shumicë	27	33

Sasia vëllimore e ujit të furnizuar për KRU 'Mitrovica', në tërësi dhe një pjesë për KRU 'Prishtina', ka shënuar rritje në 2014, është KRU 'Prishtina', ajo e cila ka marrë për rreth 1.5 mil. m<sup>3</sup>, Ujë me tepër, në vitin 2014 se sa ishte në vitin 2013. Vlera e keshit të arkëtuar, ka pasur rritje të konsiderueshme, meqenëse kompania ka arritur ti arkëtoj borxhet nga KRU 'Mitrovica, për vitet paraprak (2012, 2013 dhe vitin aktual 2014). Përderisa vlera e koston së operimit për pjesën e furnizimit të ujësllësëve është më e lartë se në vitin 2013. E ndikuar nga rritja e numrit të stafit në këtë aktivitet.

**Tabela 14, Treguesit e Peformances për NHE 'Iber-Lepenc'**

Treguesi i performancës	2013	2014
Shkalla e arkëtimit	26%	149%
Norma e punës	1.07	1.17
Norma e mbulimit të punës	0.28	1.75
Kostoja e operimit për njësi (€/m <sup>3</sup> )	0.02	0.02

Meqenëse natyra e shërbimeve të ujit me shumicë është me ndryshe nga aktivitetet e furnizimit me ujë të pijshëm, mundësia e vlerësimit të performancës është e kufizuar vetëm në disa tregues financiar. Në tabelën 10, është dhënë një pasqyrë e treguesve financiar në bazë të cilëve mund të vlerësohet performanca e NHE 'Iber Lepenci' gjatë vitit 2013 krahasuar me vitin 2012.

Të gjithë treguesit financiar të kësaj kompanie, kanë shënuar progres në vitin 2014, në raport me vitin 2013, në përjashtim të shpenzimeve për njësi e cila ka mbet në nivel të njëjtë. Shkalla e arkëtimit në vitin 2014, është rritur në nivelin 149%. Ashtu siq edhe kemi cekur me lartë tek rritje e vleres së keshit, kjo ka ardhë si rezultat i arkëtimit të borxheve nga vitet paraprake 2012, 2013 dhe 2014.

Ngritje mjaftë e lartë vërehet edhe tek norma e mbulimit të punës e cila krahasuar me vitin paraprak ka pasur rritje prej 1.47. Kjo ngritje është ndikuar kryesisht nga norma e lart e të hyrave të arkëtuar, përkundër ngritjes së shpenzimeve operative.

## Pjesa D

# Aktivitetet e Komisioneve Këshilluese të Konsumatorëve(KKK)

---

## 6 Aktivitetet e KKK

Që nga themelimi, ZRRUK, ka njoftë të drejtën që konsumatorët të kyqen në dhënien e kontributit në përmirësimin e shërbimeve të ujit. Ka 9 vite që këtë të drejtë të konsumatorëve, ZRRUK e ka institucionalizuar duke krijuar KKK në shtatë regjionet ku KRU ofrojnë shërbimet e tyre. Gjatë kësaj periudhe KKK, kanë vazhduar të rrisin transparencën në sektor dhe rritjen e ndërgjegjësimit, të publikut mbi të drejtat dhe detyrimet e konsumatorëve. Anëtarët e rinjë të KKK, në shtatë rajonet e Kosovës, janë emruar në Qershor dhe Korrik të vitit 2014, në pajtim me Rregullen (R-8/U&M). Në total KKK, përbehen nga 32, anëtarë me nga një përfaqësues nga të gjitha komunat, përjashtuar ato në pjesen e veriut të Kosovës. Gjatë kësaj periudhe raportuese KKK, nën përkrahjen e ZRRUK, kanë ndërmarrë aktivitete të ndryshme:

**Udhëzuesi për Konsumatorë**, është punuar me qëllim të lehtësimit për konsumatorët, gjatë parashtrimit të ankesave të tyre në Komisionin Këshillues të Konsumatorëve.

**Broshura “Mbrojtja e Interesave të Konsumatorëve”**, në bashkpunim me kompaninë “KIWER Consulting” - implementues i projektit të financuar nga SDC (Zyra Zvicerane për Zhvillim), janë përgaditë dhe botuar 2 000 copë broshura “Mbrojtja e Interesave të Konsumatorëve”. Ato janë shpërndare te konsumatorët. Broshura ka pasur qëllimin e informimit të konsumatorëve për: ZRRUK, rolin dhe detyrat e KKK, mënyrën e parashtrimit të ankesave nga konsumatorët në rastin e pakënaqësive ndaj KRU-ve, procedurat ankimore, mënyrat e trajtimit të ankesave nga KKK e çështje tjera.

**Takimet me Kompanitë Rajonale të Ujësjellësit**, me qëllim të udhëzimit për ndryshimin e formatit dhe përmbajtjes së vendimeve/përgjigjeve si dhe janë marrë informacione rreth shqyrtimit të ankesave të konsumatorëve nga KKK. Gjatë vitit 2014, janë mbajtur 77 takime në të cilat janë shqyrtuar ankesat e konsumatorëve. Takime e KKK, kanë qenë të hapura për publikun, në disa raste kanë marrë, pjesë përfaqësuesit e KRU, Konsumatorëve, OJQ-ve dhe Mediat. Për me tepër në keto takime, janë shqyrtuar edhe çështje të tjera të cilat, janë në interes të konsumatorëve.

**Tabela 15, Numri i ankesave të parashtruara në KKK**

REGJIONI	2013		2014	
	Ankesa të parashtruara	Ankesa të zgjidhura	Ankesa të parashtruara	Ankesa të zgjidhura
KKK -Prishtinë	42	23	130	111
KKK -Mitrovicë	1	-	0	-
KKK- Pejë	-	-	0	-
KKK -Gjakovë	6	5	18	22
KKK- Prizren	3	2	11	8
KKK -Ferizaj	7	7	13	10
KKK -Gjilan	3	3	5	5
Gjithsejtë	62	40	177	156

Në të gjitha KKK, në vitin 2015, janë adresuar në total 177 ankesa, prej të cilave, janë zgjidhur 156. Pjesa më e madhe e ankesave, janë pranuar nga KKK i regjionit të Prishtinës'. Pra ka një rritje të konsiderueshme të ankesave ndaj KRU 'Prishtina', janë arsyet financiare (kontestimi i borgjeve, zbritja/shlyerja e borxhit, faturimi paushall si dhe faturim i lartë). Si duket praktika e aplikuar nga KRU 'Prishtina', rreth adresimit të borgjeve, tek përmbaresit privat është shkaku i rritjes së ankesave të drejtuar në KKK-Prishtinës. Në përgjithësi më tepër, janë ankuar konsumatorët shtëpika (158 ankesa) dhe me pak konsumatorët, komercial-industrial (18 ankesa).

## 7 SFIDAT PËR TË ARDHMËN

Padyshim se shumë sfida i kanë ofruesit e shërbimeve të ujit si dhe sektori në tërësi në Kosovë. Ne në vazhdimësi në raportet e performancës i kemi trajtuar sfidat të cilat janë të ndërlidhura me efikasitetin financiar dhe operative siç janë: Përmirësimi i faturimit dhe arkëtimit, Zvoglimi i shpenzimeve operative, Reduktimi i UPF, mandej përbushja e standardeve të shërbimit, etj. **Jo me pak sfiduese është edhe përbushja e detyrimeve ligjore të cilat ofruesit e shërbimeve i kanë ndajë kërkesave ligjore të cilat, tangojn sektorin e shërbimeve të ujit.** Në Kosovë korniza ligjore Rregullatore dhe korniza e përgjithëshme ligjore e shërbimeve të ujit, është mjaftë konsistence dhe pa kundërtënje. Përbushja e të gjithave kërkesave ligjore nga Ofruesit e shërbimeve është e obligueshme. Megjithatë një pjesë e tyre është e domosdoshme të adresohen në një afat kohor sa më të shpejtë, meqëse kanë impaktë të menjëhershëm në kualitetin e shërbimit.

- **Monitorimi i Cilësis së Ujit**

Cilësia e ujit të pijshëm, është një prej standardeve më të rëndësishme të shërbimit, e cila duhet siguar nga ofruesit e shërbimeve. Me Udhëzimin Administrativ Nr. 16/2012 të miratuar nga Qeveria e Kosovës në muajin dhjetor të vitit 2012, janë përcaktuar standardet e cilësisë që duhet ti përbush uji që është i destinuar për konsum njerëzor i cili furnizohet nga ofruesit e shërbimeve të furnizimit publik me ujë. Gjithashtu me këtë UA janë përcaktuar edhe përgjegjësitë e institucioneve relevante në zbatimin e dispozitave të UA, para së gjithash të Qendrës së Ujit pranë Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike (IKSHP) Kompanive Rajonale të Ujësjellsit (KRU), Zyrës Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim (ZRRUK), Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) por edhe ministrive tjera. UA. 16/2012, është në pajtim me Direktivën e Ujit të Pijes të Bashkimit Europian Nr. 98/83/EC, Praktikisht me nxjerrjen e këtij UA. Kosova, ka transpozuar legjislacionin e BE-së sa i përket cilësisë së ujit të pijes. Është e kurtë se cilësia e ujit të pijshëm, mund të garantohet, vetëm nëse do të ketë monitorim efektiv, njëkohësisht nga Qendra e ujit (monitorimi jashtëm) si dhe nga KRU, (monitorimi i brendshëm) i cilësisë së ujit. Në bazë të UA 16/2012, është paraparë të bëhet nga KRU, prandaj ato janë të obliguara të kryejnë analiza të rregullta të cilësisë së ujit, për të siguruar se uji furnizuar prej tyre, përputhet me standardet vendore për ujë të pijshëm. Shumica e KRU edhe pse i kanë laboratorët dhe bëjnë disa testime bazike, ato ende nuk janë plotësisht të pajtura me staf dhe aparaturë të nevojshme për ti plotësuar kriteret të cilat dalin nga UA. Deri me tani të gjitha KRU, kanë hartuar 'Planet e monitorimit intern', të cilat, janë dorëzuar dhe pranuar nga Qendra e ujit dhe ZRRUK, mbetet tek KRU të vazhdohet me implementimin e përmes laboratorëve të tyre – të akredituar apo përmes laboratorit të kontraktuar.

- **Verifikimi i saktësis dhe kalibrimi i Ujëmatësave**

Viteve të fundit, gjithnjë e më shumë po ngritet shqetësimi i konsumatorëve rreth saktësis së ujëmatësëve. Faturimi: i saktë, i drejtë, i ligjshëm dhe transparent për shërbimet e ujit përmes ujëmatësit është e drejtë themelore e konsumatorit dhe njëkohësisht edhe obligimi ligjor për KRU, për të siguruar.

Faturimi i shërbimeve të ujit duhet të llogaritet në bazë të konsumit, real përmes ujëmatësit të verifikuar. Vlerësimi i saktë i përdorimit të ujit është jetik, jo vetëm për konsumatorin i cili do të faturohet vetëm me ujin të cilin, në të vërtetë e ka konsumuar. Problemet që lidhen me saktësinë e ujëmatësit, lindin veçanërisht në rastin me ndërprerje, e cila është e zakonshme tek disa KRU. Në disa raste Ujëmatësit përgjatë furnizimit me ndërprerje regjistrojnë flukset e ajrit, në rastin kur furnizimi me ujë vendoset, ujit shtyn ajrin nëpërmjet gypave të furnizimit dhe mund të çojë në mbi-regjistrimin e konsumit nga ujëmatësit. Po ashtu edhe menaxhimi jo adekuat i presionit të ujit dhe ndryshime të papritura të presionit në sistemin e furnizimit me ujë mund të dëmtojë ujëmatësa deri në atë masë që shumë ujëmatësa mos të jenë funksional. Agjencioni i Metrologjisë së Kosovës si Institucion, ka vendosur kriteret që garantojnë sakteësinë e ujëmatësve përmes

përmbushjes së kërkesave ligjore (Ligji për Metrologji Nr.03/L-203 dhe Ligji Nr.04/L-124 për Ndryshimin e Ligjit për Metrologji) dhe Udhëzimet Administrative në kontekst të testimit, verifikimit, kalibrimin dhe mirëmbajtjes së rregullt të ujëmatësëve.

Në këtë drejtim, në mënyrë specifike përgjegjësit e KRU, janë: (i) Përdorimi i ujëmatësve të cilat janë të verifikuar, (ii) mbajtja e ujëmatësit në gjendjen e duhur, teknike për të siguruar saktësi të matjes, (iii) mirëmbajtja dhe verifikimi i të gjithë ujëmatësëve që janë në përdorim, si dhe (iv) të mbajë evidencë për mirëmbajtjen dhe verifikimin e ujëmatësëve. Pra, KRU duhet të ruajë besimin e konsumatorëve duke garantuar, se ujin që ata e konsumojnë është i matur me saktësi, që d.th. se sasia shitur e ujit është saktësisht e njëjtë me sasinë e dorëzuar. Përgjegjës për sigurimin dhe verifikimin e rregullt dhe jo të rregullt të ujëmatësit është e vet shfrytëzuesit-KRU.

KRU, mundë të vendosin për përdorim vetëm ato ujëmatës të cilët i plotësojnë kërkesat tekniko meterologjike sipas Ligjit për Meterologji dhe të cilët kanë kaluar procedurat e përshkruara të vlerësimit të konformitetit. Një Ujëmatës do të konsiderohet i saktë nëse, sipas UA i nënshtrohen një testi standarde nga ana e AMK, përmes servisit të autorizuar.

Vetëm një servis i autorizuar nga AMK, egziston në Kosovë, i cili është nën menagjimin e KRU 'Hidroregjioni Jugor', kapaciteti i tij është i mjaftueshëm për të shërbyer për nevoja e veta, të kesaj KRU. Megjithatë ky servis ka kryer shërbime edhe për kompanitë e tjera sa herë ato kane kërkuar një shërbim të tillë. Një servis i pautorizuar dhe me kapacitet të kufizuar egziston dhe është funksional edhe në KRU Hidromorava (NJ.O-Viti).

KRU 'Prishtina', është në fazën e finalizimit të servisit të sajë, i cili është i pajisur me paisje moderne, KRU 'Prishtina', ka parashtruar kërkesë tek AMK, për liçencimin e servisit të ujëmatësëve. Kapaciteti i këtij servis është përtej nevojave të kësaj kompanie.

Mbetet që KRU e tjera ose të themelojnë serviset e tyre vetanake apo edhe të bëjnë kontraktimin e shërbimit për testimin rutin apo të rastit të ujëmatësëve tek Serviset e autorizuar.

- **Politika tarifore për shërbimin e trajtimit të ujërave të zeza**

Tanimë me është e qartë se Kosova, gradualisht është duke hyrë në periudhën ku shërbimi i trajtimit të ujërave të zeza është duke marre fokusin e angazhimit të institucioneve dhe agjencioneve zhvillimore që përkrahen sektorin e shërbimeve të ujit në vend. Mënjanimi i duhur i ujërave të zeza është çështje thelbësore për shëndetin publik. Kjo është çështje brengosëse e cila sa shkon e rritet në Kosovë. Mungesa e aranzhimeve për mënjanimin e tyre ka bërë që lumenjtë dhe burimet nëntokësore në vend çdo herë e më shumë të rrezikohen nga kanalizimi i ujërave të zeza.

Aktualisht në vend, ekziston vetëm një impiantë i trajtimit të ujërave të zeza në qytetin e Skenderajt me kapacitet prej 10,000 banoresh e cila është nën menaxhimin e KRU 'Mitrovica'. Ekzistojnë po ashtu edhe disa Impiante të vogla për trajtimit të ujërave të zeza si p.sh ajo në fshatin Harilaç, apo ajo në Pallatin e Drejtësisë, që sapo është ndërtuar në periferi të Prishtinës. Për me tepër deri me tani, janë përmbyllur ose janë në fazën përmbyllëse të gjitha projektet studimore të fizibilitetit të impianteve të trajtimit të ujërave të zeza. Disa nga e agjencionet zhvillimore (BE, KfW, SCO, Agjencia Çeke për Zhvillim), kanë filluar mbështetjen konkrete në ndërtimin e kolektorëve dhe impianteve të trajtimit të ujërave të zeza siç është rasti me impiantit të ujërave të zeza në Prizren, projekti i "Përmirësimit të cilësisë së ujit në liqenin e Badovcit, në Prishtinë, etj.

Sfide po aq e madhe sa është edhe vetë ndërtimi i këtyre impianteve për shoqërinë Kosovare (Në mesin e kushteve dhe kriterëve që duhet plotësuar për hyrje në Bashkimin Evropianë, është potencuar edhe trajtimi i ujërave të zeza), për ZRRUK, mbetet përcaktimi i politikave të drejta tarifore të cilat do të sigurojnë qëndrueshmëri operative dhe financiare të ofruesve të shërbimeve dhe njëkohësisht duke marre për bazë përbalueshmërin e ngarkesave tarifore nga ana e konsumatorëve.

ZRRUK, duke parë se shërbimi i trajtimit të ujërave të zeza, ka specifikat e saja, dhe duke marrë për bazë: nevojën e përgjithshme për ambient të pastër jetësor si dhe parimet e barazisë, mos diskriminimit, dhe ekuilibrit të tarifave, por edhe për të krijuar mundësi të pagesës së faturave nga të gjithë marsit e shërbimeve, në vazhdimësi është angazhuar për ri-definimin e politikave tarifore të shërbimeve të trajtimit të ujërave të zeza. Në këtë drejtim ZRRUK, ka marrë mbështetjen e Agjencionit Zviceran për Zhvillim SCO, me një projekt afatshkurtër i cili ka rezultuar me një dokumente studimore, në të cilin, janë shpalosur opinionet e saja të cilat kanë pasqyruar qëndrimet e palëve vendore të interesit, si dhe përvojat e shërbimeve të tilla në regjion.

Një nga opsionete me të favorizuar edhe nga Institucionet vendor dhe i aplikuar edhe në disa vende të Regjionit është, se për këtë shërbim duhet të vazhdohet të aplikohet tarifa unike për kategoritë caktuar të konsumatorëve të shërbyer në gjithë zonën e shërbimit të një KRU.

Edhe ZRRUK, preferon qasjen e ngarkesës unike d.m.th. të njëjtat tarifa të shërbimit të ujërave të zeza të trajtuara për të gjitha grupimet e konsumatorëve, pavarësisht faktit se a trajtohen apo jo të gjitha ujërat e zeza në impiant. Kjo ngërthen në vete faktin se të gjitha kostot e operimit të impiantit duhet të paguhet nga konsumatorët e regjionit. Kjo formë është ma e lehtë dhe ma e thjeshtë për kompaninë, rregullatorin, por edhe konsumatorët, përjashtuar konsumatorët që nuk u trajtohen ujërat e zeza. Opsionet dhe qasja mund të jenë të ndryshme, si p.sh. shpërndarja e barabartë - proporcionale e kostove, ose 70% të totalit të kostove të paguhet nga marrësit e shërbimeve dhe 30% nga konsumatorit e tjerë që nuk u trajtohen ujërat e zeza, apo edhe në forma të tjera, ku si pale e interesit do të jetë Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinore(MAPH), gjegjësisht Qeveria e Republikës së Kosovës. P.sh. Qeveria nga buxheti shtetërore të ndaj shuma të caktuara të mjeteve për të mbuluar një pjesë të kostove të impianteve të trajtimit të ujërave të zeza për një periudhë kalimtare.

Si do që të jetë ZRRUK, edhe në të ardhmen do të vazhdojë të merret me këtë çështje, deri në sqarimin përfundimtarë të qasjes së sajë dhe përgatitjes së akteve të veta rregullative, gjithnjë duke dëgjuar me kujdesë edhe opinionet e palëve të interesit.

## SHTOJCA 1 Të dhënat e detajuara të performancës

Procesi i Monitorimit të Performancës dhe Vlerësimi Krahasues, kërkon mbledhjen e rregullt të të dhënave të cilat janë të sakta dhe me besueshmëri dhe duhur në mënyrë që nga analiza e tyre të rezultojnë informacione sa më objektive. Disponueshmëria e të dhënave të tilla varet kryesisht nga përdorimi dhe menaxhimi i një sistemi të informacionit të KRU, që është i azhurnuar dhe përditësuar në baza të rregullta.

Për realizimin e kësaj përgjegjësie të rëndësishme, ZRRUK ka krijuar sistemin e raportimit dhe shpërndarjes së informacionit, baza e të cilit është i ashtuquajtur: Plani i Monitorimit Vjetor (PMV), si dhe Raportimi Mujor Operativ, Financiar dhe i Shërbimeve ndaj Konsumatorëve (ROFK), të cilët përmbajnë të dhëna nga të gjitha fushat e punës së ofruesve të shërbimeve, përfshirë të dhëna Financiare, Operative si dhe të dhëna nga Shërbimi ndaj Konsumatorëve. Në kuadër të raportimit të rregullt (Mujor dhe Vjetor) pa mëdyshje, përgjegjësia për raportimin e të dhënave qëndron tek Kompanitë, ndërsa ZRRUK ka përgjegjësi për vlerësimin e këtyre të dhënave në kontekst të saktësisë dhe besueshmërisë së burimit të tyre.

Të dhënat e përdorura në këtë raport të performancës, janë të dhëna bazë të marra nga raportet vjetore të KRU të raportuara në ZRRUK përmes sistemit të Planit të Monitorimit Vjetor. Për qeshtje të diskutimit të tregusve po ashtu janë shfrytëzuar edhe të dhëna të raportuara përmes raportit mujor të raportuar sipas raportit Operativ, Financiar dhe Shërbim të Konsumatorëve (ROFK).

Për të prodhuar informacione sa më objektive, të dhënat e raportuara i janë nënshtruar procesit të rregullt vjetor auditues nga ana e ZRRUK, për të verifikuar saktësinë dhe besueshmërinë e tyre.

Ekipi auditues ka vlerësuar se të dhënat në përgjithësi kanë qenë saktë të raportuara në raport me të gjeturat në sistemin e informacionit të Kompanive, disa mangësi janë vertetuar të jenë për shkak të moskuptimit të definicioneve të të dhënave. Sa i përket besueshmërisë ekipi i auditimit të ZRRUK, konsideron se të dhënat financiare janë plotësisht të besueshme, përderisa të dhënat operative dhe të dhënat e shërbimeve ndaj konsumatorëve jo gjithë herë kanë qenë të besueshme.

- Të gjitha të dhënat financiare të shprehura në EUR janë të përshtatura në nivelet e çmimeve të mesit të vitit 2014, në përputhje me statistikën e publikuar të inflacionit për të mundësuar krahasimet e duhura nga viti në vit.
- Përcaktimi i vlerës së aseteve është bërë në bazë të Bazës Rregullatore të Aseteve;
- Mirëmbajtja kapitale është definuar si kombinim i ripërtëritjeve infrastrukturore dhe zhvlerësimit sipas kostos aktuale të aseteve jo-infrastrukturore;
- Provizionimi i borxheve të këqija (shlyerja) është definuar si dallimi në mes faturimit dhe arkëtimit të të ardhurave nga viti i kaluar.
- Performanca e arkëtimit të të ardhurave është definuar si dallimi në mes të faturimit për shërbimet e ujit dhe ujërave të zeza (duke përjashtuar taksat e kyçjeve dhe të ardhurat tjera) dhe të ardhurat në kesh për shërbimet e ujit dhe ujërave të zeza (poashtu duke përjashtuar taksat e kyçjes dhe të ardhurat tjera).

Për të vlerësuar përmbushjen e standardit për kualitetin e ujit të pijshëm, ZRRUK ka shfrytëzuar të dhënat e raportuara nga Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik të Kosovës (IKSHPK) i cili ka përgjegjësinë për monitorimin dhe testimin e ujit të distribuar nga ofruesit e shërbimeve të ujit. Të dhënat në lidhje me statistikën e popullsisë, si dhe të dhënat për inflacionin (IQK), janë marrë nga Agjensioni i Statistikave të Kosovës (ASK).

Statistikat e detajuara të performancës së shtatë KRU, janë të paraqitura në tabelat në vijim:

## KRU Prishtina (Prishtinë)

Kategoria / nën-kategoria	Nën-nën-kategoria	Treguesi	Ref	Njësia	2013	2014
<b>W - Furnizimi me ujë</b>						
<b>Jo-financiar (teknik)</b>						
Standardet e shërbimit	Cilësia	Cilësia e ujit (bakteriologjike)	W.1.A.01	% e tes. të kaluara	99.4%	99.5%
		Cilësia e ujit (fizike dhe kimike)	W.1.A.02	% e tes. të kaluara	100%	99.2%
	Shtypja	Pronat e ndikuara nga shtypja e ulët	W.1.A.03	Nr	77	145
		Pronat e ndikuara nga shtypja e ulët	W.1.A.04	% e pronave	0.09%	0.16%
	Besueshmëria	Pronat që furnizohen 24 orë me ujë	W.1.A.05	Nr	19,356	16,418
		Pronat që furnizohen 24 orë me ujë	W.1.A.06	% e pronave	22%	18%
		Pronat që furnizohen 18-24 orë me ujë	W.1.A.07	Nr	33,335	23,914
		Pronat që furnizohen 18-24 orë me ujë	W.1.A.08	% e pronave	38%	26%
		Pronat që furnizohen më pak se 18 orë me ujë	W.1.A.09	Nr	34,007	51,893
		Pronat që furnizohen më pak se 18 orë me ujë	W.1.A.10	% e pronave	39%	56%
Shërbueshmëria infrastrukture	Uji i pa-faturuar	Uji i pa-faturuar (totali)	W.1.B.01	m3 në vit	20,812,306	18,452,520
		Uji i pa-faturuar (për kycje)	W.1.B.02	litra për kons. për ditë	583	486
		Uji i pa-faturuar (për kycje) – i rregulluar	W.1.B.03	litra për kons. për ditë	683	588
		Uji i pa-faturuar (si përqindje e prodhimit)	W.1.B.04	% e prodhimit	50%	49%
	Plasaritjet e gypave	Frekuenca e plasaritjeve në rrjetin e gypave	W.1.B.05	plasaritjet për muaj	142	154
		Plasaritjet e gypave të rrjetit për 100 km të gypit	W.1.B.06	Nr / 100 km	213	148
<b>Jo-financiar (komercial)</b>						
Shtrirja me shërbime	Shtëpiak	Konsumatorët shtëpiak të shërbyer	W.2.A.01	Nr	86,698	92,225
		Shtrirja (konsumatorët shtëpiak të shërbyer në raport me totalin)	W.2.A.02	% totali i kons. shtëpiak	96.4%	101%
	Kycjet e reja	Kycjet e reja (konsumatorët shtëpiak)	W.2.A.03	Nr	5,009	6,045
		Kycjet e reja (konsumatorët komercial dhe institucional)	W.2.A.04	Nr	646	837
Matja e ujit	Norma me ujëmatës	Konsumatorët shtëpiak më ujëmatës në raport me totalin e konsumatorëve shtëpiak	W.2.B.01	% totali i kons. shtëpiak	97%	98%
		Konsumatorët kom & inst me ujëmatës në raport me totalin e konsumatorëve kom & inst	W.2.B.02	% kom & inst	99%	99%
	Ujëmatësit e instaluar	Ujëmatësit e instaluar (shtëpiak)	W.2.B.03	Nr	75	288
		Ujëmatësit e instaluar (kom & inst)	W.2.B.04	Nr	8	67
Ankesat	Ankesat	Ankesat e pranuar (teknike)	W.2.C.01	Nr	2,548	5,591
		Ankesat e pranuar (komerciale)	W.2.C.02	Nr	4,349	5,180
<b>Financiar</b>						
Shitjet	Volumet	Volumi i shitjeve për konsumatorët shtëpiak (me ujëmatës)	W.3.A.01	m3	15,005,238	14,714,305
		Volumi i shitjeve për konsumatorët shtëpiak (me ujëmatës) në raport me vlerësimet sipas planit	W.3.A.02	% e vlerësimit sipas planit	78%	72%
		Volumi i shitjeve për konsumatorët shtëpiak (pa ujëmatës)	W.3.A.03	m3	849,348	500,630
		Volumi i shitjeve për konsumatorët shtëpiak (pa ujëmatës) në raport me vlerësimet sipas planit	W.3.A.04	% e vlerësimit sipas planit	126%	200%
		Volumi i shitjeve për konsumatorët kom & inst (me ujëmatës)	W.3.A.05	% e vlerësimit sipas planit	4,564,882	3,870,125
		Volumi i shitjeve për konsumatorët kom & inst (me ujëmatës) në raport me vlerësimet sipas planit	W.3.A.06	% e vlerësimit sipas planit	90%	75%
		Volumi i shitjeve për konsumatorët kom & inst (pa ujëmatës)	W.3.A.07	% e vlerësimit sipas planit	14,123	17,307
		Volumi i shitjeve për konsumatorët kom & inst (pa ujëmatës) në raport me vlerësimet sipas planit	W.3.A.08	% e vlerësimit sipas planit	0%	0%
	Vlerat	Vlera e ujit të shitur për konsumatorët shtëpiak	W.3.A.09	EUR	7,083,621	6,903,924
		Vlera e ujit të shitur për konsumatorët shtëpiak në raport me vlerësimet sipas planit	W.3.A.10	% e vlerësimit sipas planit	74%	68%
		Vlera e ujit të shitur për konsumatorët kom & inst	W.3.A.11	EUR	4,380,743	3,806,792
		Vlera e ujit të shitur për konsumatorët kom & inst në raport me vlerësimet sipas planit	W.3.A.12	% e vlerësimit sipas planit	84%	71%
Kostoja për njësi	Prodhimi	Kostoja operative për njësi të ujit të prodhuar	W.3.B.01	EUR/m3	0.054	0.0629
		Kostoja totale për njësi të ujit të prodhuar	W.3.B.02	EUR/m3	0.058	0.067
	Kostoja totale	Kostoja për njësi të ujit të shitur	W.3.B.03	EUR/m3	0.410	0.496
		Kostoja për njësi të ujit të shitur dhe të paguar	W.3.B.04	EUR/m3	N/A	N/A
Shpenzimet kapitale	Mirëmbajtja kapitale	Totali i shpenzimeve për mirëmbajtje kapitale	W.3.C.01	EUR	622,014	522,014
		Totali i shpenzimeve për mirëmbajtje kapitale në raport me planin	W.3.C.02	% e vlerësimit sipas planit	8%	7%
		Totali i shpenzimeve për mirëmbajtje kapitale në raport me BRA	W.3.C.03	% e BRA	2.9%	2.4%
	Rritja kapitale	Totali i shpenzimeve për rritje kapitale	W.3.C.04	EUR	8,324,762	938,550
		Totali i shpenzimeve për rritje kapitale në raport me planin	W.3.C.05	% e vlerësimit sipas planit	198%	87%

RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS PËR OFRUESIT E SHËRBIMEVE TË UJIT NË KOSOVË NË 2014

Kategoria / nën-kategoria	Nën-nën-kategoria	Treguesi	Ref	Njësia	2013	2014
<b>K- Ujërat e zeza</b>						
<b>Jo-financiar (teknik)</b>						
Standardet e shërbimit	Cilësia e ujërave të zeza të shkarkuara	Cilësia e ujërave të zeza të shkarkuara	S.1.A.01	% e tes. të kaluara	N/A	N/A
Besueshmëria	Vërshimet e rrjetit të kanalizimit	Vërshimet e rrjetit të kanalizimit	S.1.B.01	Nr	2,933	3,705
		Vërshimet e rrjetit të kanalizimit për 100 km të gypit	S.1.B.02	Nr për 100 km	863	1,090
Shërbyeshmëria	Prishjet/kolapsi i rrjetit të kanalizimit	Prishjet/kolapsi i rrjetit të kanalizimit	S.1.C.01	Nr	0	0
		Prishjet/kolapsi i rrjetit të kanalizimit për 100 km të gypit	S.1.C.02	Nr për 100 km	0	0
	Mbingarkimet e impiantit për trajtimin e ujërave të zeza	Mbingarkimet e impiantit për trajtimin e ujërave të zeza	S.1.C.03	Nr	N/A	N/A
<b>Jo-financiar (komercial)</b>						
Shtrirja me shërbime	Shtëpiak	Konsumatorët shtëpiak të shërbyer	S.2.A.01	Nr	69,965	75,992
		Shtrirja (konsumatorët shtëpiak të shërbyer në raport me totalin)	S.2.A.02	% totali i kons. shtëpiak	78%	83%
		Konsumatorët shtëpiak të shërbyer me trajtimin e ujërave të zeza	S.2.A.03	Nr	0	0
		Shtrirja (konsumatorët shtëpiak të shërbyer me trajtimin e ujërave të zeza në raport me totalin)	S.2.A.04	% totali i kons. shtëpiak	0	0
	Kycjet e reja	Kycjet e reja (konsumatorët shtëpiak)	S.2.A.05	Nr	5,575	6,479
		Kycjet e reja (konsumatorët komercial dhe institucional)	S.2.A.06	Nr	636	985
Ankesat	Ankesat	Ankesat e pranuar (teknike)	S.2.B.01	Nr	2,273	58
		Ankesat e pranuar (komerciale)	S.2.B.02	Nr	0	0
<b>Financiar</b>						
Shitjet	Vlerat	Vlera e shitjeve për konsumatorët shtëpiak	S.3.A.01	EUR	663,487	633,121
		Vlera e shitjeve për konsumatorët shtëpiak në raport me vlerësimet sipas planit	S.3.A.02	% e vlerësimit sipas planit	81%	62%
		Vlera e shitjeve për konsumatorët kom & inst	S.3.A.03	EUR	457,067	420,125
		Vlera e shitjeve për konsumatorët kom & inst në raport me vlerësimet sipas planit	S.3.A.04	% e vlerësimit sipas planit	76%	65%
Kostoja për njësi	Trajtimi dhe shkarkimi	Kosto operative për njësi të trajtimit dhe shkarkimit për m <sup>3</sup>	S.3.B.01	EUR/m <sup>3</sup>	N/A	N/A
		Totali i koston të trajtimit dhe shkarkimit për m <sup>3</sup>	S.3.B.02	EUR/m <sup>3</sup>	N/A	N/A
		Kostoja operative për njësi të trajtimit dhe shkarkimit për konsumator shtëpiak	S.3.B.03	EUR/ kons. shtëpiak	N/A	N/A
		Totali i koston për njësi të trajtimit dhe shkarkimit për konsumator shtëpiak	S.3.B.04	EUR/ kons. shtëpiak	N/A	N/A
	Grumbullimi	Kosto operative për njësi të grumbullimit të ujërave të zeza për konsumator shtëpiak	S.3.B.05	EUR/ kons. shtëpiak	N/A	N/A
		Totali i koston për njësi të grumbullimit të ujërave të zeza për konsumator shtëpiak	S.3.B.06	EUR/ kons. shtëpiak	N/A	N/A
		Kosto operative për njësi të grumbullimit të ujërave të zeza për konsumator shtëpiak	S.3.B.07	EUR/ kons. shtëpiak	2.78	2.97
		Totali i koston për shërbime të ujërave të zeza për konsumator shtëpiak	S.3.B.08	EUR/ kons. shtëpiak	2.84	3.14
Shpenzimet kapitale	Mirëmbajtje kapitale	Totali i shpenzimeve për mirëmbajtje kapitale	S.3.C.01	EUR	0	10,359
		Totali i shpenzimeve për mirëmbajtje kapitale në raport me planin	S.3.C.02	% e vlerësimit sipas planit	0%	3%
		Totali i shpenzimeve për mirëmbajtje kapitale në raport me BRA	S.3.C.03	% e BRA	0%	0%
	Rritja kapitale	Totali i shpenzimeve për rritje kapitale	S.3.C.04	EUR	81,169	129,948
		Totali i shpenzimeve për rritje kapitale në raport me planin	S.3.C.05	% e vlerësimit sipas planit	47.3%	776%
<b>F – Financiar</b>						
<b>Shitjet dhe arkëtimi i të ardhurave</b>						
Shitjet	Totali i shitjeve		F.1.A.01	EUR	12,584,918	11,763,962
	Totali i shitjeve në raport me planin		F.1.A.02	% e vlerësimit sipas planit	78%	68%
Eficiencia e arkëtimit	Totali i të ardhurave të arkëtuara		F.1.B.01	EUR	9,580,130	9,373,913
	Totali i tejkalimit të arkëtimit të të ardhurave		F.1.B.02	EUR	-2,712,362	-3,963,632
	Totali i tejkalimit të arkëtimit të të ardhurave (relative)		F.1.B.03	% e vlerësimit sipas planit	78%	70%
	Totali i të ardhurave të shlyera		F.1.B.04	EUR	3,214,733	3,004,787
	Totali i të ardhurave të shlyera në raport me totalin e faturimit		F.1.B.05	% e faturimit	26%	26%
	Arkëtimi i të ardhurave në raport me faturimin		F.1.B.06	% e faturimit	76%	80%
	Llogaritë e arkëtueshme		F.1.B.07	EUR	N/A	N/A
	Llogaritë e arkëtueshme në raport me qarkullimin		F.1.B.08	Qarkullimi në ditë	N/A	N/A
<b>Vlerat kyçe financiare dhe normat</b>						
Vlerat		Rjedha e lirë e parasë së gatshme	F.2.A.01	EUR	N/A	N/A
Normat	Kthimet	Kthimi në kapital	F.2.B.01	%	2.86%	-2.11%
		Kosto e borxhit	F.2.B.02	%	N/A	N/A
	Normat	Leva financiare	F.2.B.03	normë	N/A	N/A
		Mbulesa e interes të parasë së gatshme	F.2.B.04	normë	N/A	N/A

## KRU Hidroregjioni Jugor (Prizren)

Kategoria / nën-kategoria	Nën-nën-kategoria	Treguesi	Ref	Njësia	2013	2014
<b>W - Furnizimi me ujë</b>						
<b>Jo-financiar (teknik)</b>						
Standardet e shërbimit	Cilësia	Cilësia e ujit (bakteriologjike)	W.1.A.01	% e tes. të kaluara	97.0%	88.0%
		Cilësia e ujit (fizike dhe kimike)	W.1.A.02	% e tes. të kaluara	98.2%	99.6%
	Shtypja	Pronat e ndikuara nga shtypja e ulët	W.1.A.03	Nr	0	0
		Pronat e ndikuara nga shtypja e ulët	W.1.A.04	% e pronave	0%	0%
	Besueshmëria	Pronat që furnizohen 24 orë me ujë	W.1.A.05	Nr	31,869	34,148
		Pronat që furnizohen 24 orë me ujë	W.1.A.06	% e pronave	98%	99%
		Pronat që furnizohen 18-24 orë me ujë	W.1.A.07	Nr	0	200
		Pronat që furnizohen 18-24 orë me ujë	W.1.A.08	% e pronave	0%	1%
		Pronat që furnizohen më pak se 18 orë me ujë	W.1.A.09	Nr	600	300
		Pronat që furnizohen më pak se 18 orë me ujë	W.1.A.10	% e pronave	2%	1%
Shërbyeshmëria infrastrukturore	Uji i pa-faturuar	Uji i pa-faturuar (totali)	W.1.B.01	m3 në vit	11,524,935	9,063,577
		Uji i pa-faturuar (për kycje)	W.1.B.02	litra për kons. për ditë	841	705
		Uji i pa-faturuar (për kycje) – i rregulluar	W.1.B.03	litra për kons. për ditë	845	707
		Uji i pa-faturuar (si përqindje e prodhimit)	W.1.B.04	% e prodhimit	60%	59%
	Plasaritjet e gypave	Frekuenca e plasaritjeve në rrjetin e gypave	W.1.B.05	plasaritjet për muaj	214	226
		Plasaritjet e gypave të rrjetit për 100 km të gypit	W.1.B.06	Nr / 100 km	517	532
<b>Jo-financiar (komercial)</b>						
Shtrirja me shërbime	Shtëpiak	Konsumatorët shtëpiak të shërbyer	W.2.A.01	Nr	32,469	34,648
		Shtrirja (konsumatorët shtëpiak të shërbyer në raport me totalin)	W.2.A.02	% totali i kons. shtëpiak	63%	65%
	Kycjet e reja	Kycjet e reja (konsumatorët shtëpiak)	W.2.A.03	Nr	2,336	2,021
		Kycjet e reja (konsumatorët komercial dhe institucional)	W.2.A.04	Nr	316	258
Matja e ujit	Norma me ujëmatës	Konsumatorët shtëpiak më ujëmatës në raport me totalin e konsumatorëve shtëpiak	W.2.B.01	% totali i kons. shtëpiak	96%	97%
		Konsumatorët kom & inst me ujëmatës në raport me totalin e konsumatorëve kom & inst	W.2.B.02	% kom & inst	99%	99%
	Ujëmatësit e instaluar	Ujëmatësit e instaluar (shtëpiak)	W.2.B.03	Nr	1,213	1,425
		Ujëmatësit e instaluar (kom & inst)	W.2.B.04	Nr	701	255
Ankesat	Ankesat	Ankesat e pranuar (teknike)	W.2.C.01	Nr	1,406	719
		Ankesat e pranuar (komerciale)	W.2.C.02	Nr	736	742
<b>Financiare</b>						
Shitjet	Volumet	Volumi i shitjeve për konsumatorët shtëpiak (me ujëmatës)	W.3.A.01	m3	5,929,161	5,569,102
		Volumi i shitjeve për konsumatorët shtëpiak (me ujëmatës) në raport me vlerësimet sipas planit	W.3.A.02	% e vlerësimit sipas planit	109%	98%
		Volumi i shitjeve për konsumatorët shtëpiak (pa ujëmatës)	W.3.A.03	m3	341,380	373,394
		Volumi i shitjeve për konsumatorët shtëpiak (pa ujëmatës) në raport me vlerësimet sipas planit	W.3.A.04	% e vlerësimit sipas planit	90%	165%
		Volumi i shitjeve për konsumatorët kom & inst (me ujëmatës)	W.3.A.05	% e vlerësimit sipas planit	1,462,042	1,209,840
		Volumi i shitjeve për konsumatorët kom & inst (me ujëmatës) në raport me vlerësimet sipas planit	W.3.A.06	% e vlerësimit sipas planit	76%	61%
		Volumi i shitjeve për konsumatorët kom & inst (pa ujëmatës)	W.3.A.07	% e vlerësimit sipas planit	16,097	28,473
		Volumi i shitjeve për konsumatorët kom & inst (pa ujëmatës) në raport me vlerësimet sipas planit	W.3.A.08	% e vlerësimit sipas planit	20%	68%
	Vlerat	Vlera e ujit të shitur për konsumatorët shtëpiak	W.3.A.09	EUR	2,603,835	2,542,585
		Vlera e ujit të shitur për konsumatorët shtëpiak në raport me vlerësimet sipas planit	W.3.A.10	% e vlerësimit sipas planit	101%	90%
		Vlera e ujit të shitur për konsumatorët kom & inst	W.3.A.11	EUR	1,212,376	1,054,833
		Vlera e ujit të shitur për konsumatorët kom & inst në raport me vlerësimet sipas planit	W.3.A.12	% e vlerësimit sipas planit	72%	59%
Kostoja për njësi	Prodhimi	Kostoja operative për njësi të ujit të prodhuar	W.3.B.01	EUR/m3	0.076	0.0835
		Kostoja totale për njësi të ujit të prodhuar	W.3.B.02	EUR/m3	0.079	0.086
	Kostoja totale	Kostoja për njësi të ujit të shitur	W.3.B.03	EUR/m3	0.382	0.415
		Kostoja për njësi të ujit të shitur dhe të paguar	W.3.B.04	EUR/m3	N/A	N/A
Shpenzimet kapitale	Mirëmbajtja kapitale	Totali i shpenzimeve për mirëmbajtje kapitale	W.3.C.01	EUR	237,720	116,976
		Totali i shpenzimeve për mirëmbajtje kapitale në raport me planin	W.3.C.02	% e vlerësimit sipas planit	454%	43%
		Totali i shpenzimeve për mirëmbajtje kapitale në raport me BRA	W.3.C.03	% e BRA	3.5%	1.7%
	Rritja kapitale	Totali i shpenzimeve për rritje kapitale	W.3.C.04	EUR	1,314,727	706,155
		Totali i shpenzimeve për rritje kapitale në raport me planin	W.3.C.05	% e vlerësimit sipas planit	289%	505%

**RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS PËR OFRUESIT E SHËRBIMEVE TË UJIT NË KOSOVË NË 2014**

Kategoria / nën-kategoria	Nën-nën-kategoria	Treguesi	Ref	Njësia	2013	2014
<b>- Ujërat e zeza</b>						
<b>Jo-financiar (teknik)</b>						
Standardet e shërbimit	Cilësia e ujërave të zeza të shkarkuara	Cilësia e ujërave të zeza të shkarkuara	S.1.A.01	% e tes. të kaluara	N/A	N/A
Besueshmëria	Vërshimet e rrjetit të kanalizimit	Vërshimet e rrjetit të kanalizimit	S.1.B.01	Nr	779	811
		Vërshimet e rrjetit të kanalizimit për 100 km të gypit	S.1.B.02	Nr për 100 km	300	300
Shërbyeshmëria	Prishjet/kolapsi i rrjetit të kanalizimit	Prishjet/kolapsi i rrjetit të kanalizimit	S.1.C.01	Nr	0	88
		Prishjet/kolapsi i rrjetit të kanalizimit për 100 km të gypit	S.1.C.02	Nr për 100 km	0	32.6
	Mbingarkimet e impiantit për trajtimin e ujërave të zeza	S.1.C.03	Nr	N/A	N/A	
<b>Jo-financiar (komercial)</b>						
Shtrirja me shërbime	Shtëpiak	Konsumatorët shtëpiak të shërbyer	S.2.A.01	Nr	28,972	29,811
		Shtrirja (konsumatorët shtëpiak të shërbyer në raport me totalin)	S.2.A.02	% totali i kons. shtëpiak	56%	56%
		Konsumatorët shtëpiak të shërbyer me trajtimin e ujërave të zeza	S.2.A.03	Nr	0	0
		Shtrirja (konsumatorët shtëpiak të shërbyer me trajtimin e ujërave të zeza në raport me totalin)	S.2.A.04	% totali i kons. shtëpiak	0%	0%
	Kycjet e reja	Kycjet e reja (konsumatorët shtëpiak)	S.2.A.05	Nr	-159	1,837
		Kycjet e reja (konsumatorët komercial dhe institucional)	S.2.A.06	Nr	229	269
Ankesat	Ankesat	Ankesat e pranuar (teknike)	S.2.B.01	Nr	57	45
		Ankesat e pranuar (komerciale)	S.2.B.02	Nr	32	20
<b>Financiar</b>						
Shitjet	Vlerat	Vlera e shitjeve për konsumatorët shtëpiak	S.3.A.01	EUR	267,561	252,668
		Vlera e shitjeve për konsumatorët shtëpiak në raport me vlerësimet sipas planit	S.3.A.02	% e vlerësimit sipas planit	97%	72%
		Vlera e shitjeve për konsumatorët kom & inst	S.3.A.03	EUR	130,137	108,162
		Vlera e shitjeve për konsumatorët kom & inst në raport me vlerësimet sipas planit	S.3.A.04	% e vlerësimit sipas planit	69%	53%
Kostoja për njësi	Trajtimi dhe shkarkimi	Kosto operative për njësi të trajtimit dhe shkarkimit për m <sup>3</sup>	S.3.B.01	EUR/m <sup>3</sup>	N/A	N/A
		Totali i koston të trajtimit dhe shkarkimit për m <sup>3</sup>	S.3.B.02	EUR/m <sup>3</sup>	N/A	N/A
		Kostoja operative për njësi të trajtimit dhe shkarkimit për konsumator shtëpiak	S.3.B.03	EUR/ kons. shtëpiak	N/A	N/A
		Totali i koston për njësi të trajtimit dhe shkarkimit për konsumator shtëpiak	S.3.B.04	EUR/ kons. shtëpiak	N/A	N/A
	Grumbullimi	Kosto operative për njësi të grumbullimit të ujërave të zeza për konsumator shtëpiak	S.3.B.05	EUR/ kons. shtëpiak	N/A	N/A
		Totali i koston për njësi të grumbullimit të ujërave të zeza për konsumator shtëpiak	S.3.B.06	EUR/ kons. shtëpiak	N/A	N/A
		Kosto operative për njësi të grumbullimit të ujërave të zeza për konsumator shtëpiak	S.3.B.07	EUR/ kons. shtëpiak	4.03	4.56
		Totali i koston për shërbime të ujërave të zeza për konsumator shtëpiak	S.3.B.08	EUR/ kons. shtëpiak	4.08	4.61
Shpenzimet kapitale	Mirëmbajtje kapitale	Totali i shpenzimeve për mirëmbajtje kapitale	S.3.C.01	EUR	40	0
		Totali i shpenzimeve për mirëmbajtje kapitale në raport me planin	S.3.C.02	% e vlerësimit sipas planit	0%	0%
		Totali i shpenzimeve për mirëmbajtje kapitale në raport me BRA	S.3.C.03	% e BRA	0%	0%
	Rritja kapitale	Totali i shpenzimeve për rritje kapitale	S.3.C.04	EUR	288	176,993
		Totali i shpenzimeve për rritje kapitale në raport me planin	S.3.C.05	% e vlerësimit sipas planit	0%	0%
<b>F - Financiar</b>						
<b>Shitjet dhe arkëtimi i të ardhurave</b>						
Shitjet	Totali i shitjeve		F.1.A.01	EUR	4,213,909	3,958,247
	Totali i shitjeve në raport me planin		F.1.A.02	% e vlerësimit sipas planit	90%	77%
Eficienca e arkëtimit	Totali i të ardhurave të arkëtuara		F.1.B.01	EUR	3,044,655	2,987,537
	Totali i tejkallimit të arkëtimit të të ardhurave		F.1.B.02	EUR	-485,175	-1,004,618
	Totali i tejkallimit të arkëtimit të të ardhurave (relative)		F.1.B.03	% e vlerësimit sipas planit	86%	75%
	Totali i të ardhurave të shlyera		F.1.B.04	EUR	1,094,037	1,169,254
	Totali i të ardhurave të shlyera në raport me totalin e faturimit		F.1.B.05	% e faturimit	26%	30%
	Arkëtimi i të ardhurave në raport me faturimin		F.1.B.06	% e faturimit	72%	75%
	Llogaritë e arkëtueshme		F.1.B.07	EUR	N/A	N/A
	Llogaritë e arkëtueshme në raport me qarkullimin		F.1.B.08	Qarkullimi në ditë	N/A	N/A
<b>Vlerat kyçe financiare dhe normat</b>						
Vlerat	Rjedha e lirë e parasë së gatshme		F.2.A.01	EUR	N/A	N/A
Normat	Kthimet	Kthimi në kapital	F.2.B.01	%	1.33%	-2.75%
		Kosto e borxhit	F.2.B.02	%	N/A	N/A
	Normat	Leva financiare	F.2.B.03	normë	N/A	N/A

## KRU Hidrodrini (Pejë)

Kategoria / nën-kategoria	Nën-nën-kategoria	Treguesi	Ref	Njësia	2013	2014
<b>W- Furnizimi me ujë</b>						
<b>Jo-financiar (teknik)</b>						
Standardet e shërbimit	Cilësia	Cilësia e ujit (bakteriologjike)	W.1.A.01	% e tes. të kaluara	98.6%	97.7%
		Cilësia e ujit (fizike dhe kimike)	W.1.A.02	% e tes. të kaluara	89.5%	96.3%
	Shtypja	Pronat e ndikuara nga shtypja e ulët	W.1.A.03	Nr	0	0
		Pronat e ndikuara nga shtypja e ulët	W.1.A.04	% e pronave	0%	0%
	Besueshmëria	Pronat që furnizohen 24 orë me ujë	W.1.A.05	Nr	30,865	34,467
		Pronat që furnizohen 24 orë me ujë	W.1.A.06	% e pronave	99%	99%
		Pronat që furnizohen 18-24 orë me ujë	W.1.A.07	Nr	205	205
		Pronat që furnizohen 18-24 orë me ujë	W.1.A.08	% e pronave	1%	1%
		Pronat që furnizohen më pak se 18 orë me ujë	W.1.A.09	Nr	0	0
		Pronat që furnizohen më pak se 18 orë me ujë	W.1.A.10	% e pronave	0%	0%
Shërbyeshmëria infrastrukturore	Uji i pa-faturuar	Uji i pa-faturuar (totali)	W.1.B.01	m3 për ditë	20,366,510	21,095,517
		Uji i pa-faturuar (për kycje)	W.1.B.02	litra për kons. për ditë	1,580	1,475
		Uji i pa-faturuar (për kycje) – i rregulluar	W.1.B.03	litra për kons. për ditë	1,581	1,476
		Uji i pa-faturuar (si përqindje e prodhimit)	W.1.B.04	% e prodhimit	72%	71%
	Plasartjet e gypave	Frekuenca e plasartjeve në rrjetin e gypave	W.1.B.05	plasartjet për muaj	151	128
		Plasartjet e gypave të rrjetit për 100 km të gypit	W.1.B.06	Nr / 100 km	304	256
<b>Jo-financiar (komercial)</b>						
Shtirja me shërbime	Shtëpiak	Konsumatorët shtëpiak të shërbyer	W.2.A.01	Nr	31,071	34,672
		Shtirja (konsumatorët shtëpiak të shërbyer në raport me totalin)	W.2.A.02	% totali i kons. shtëpiak	90.8%	91%
	Kycjet e reja	Kycjet e reja (konsumatorët shtëpiak)	W.2.A.03	Nr	5,349	1,854
		Kycjet e reja (konsumatorët komercial dhe institucional)	W.2.A.04	Nr	223	315
Matja e ujit	Norma me ujëmatës	Konsumatorët shtëpiak më ujëmatës në raport me totalin e konsumatorëve shtëpiak	W.2.B.01	% totali i kons. shtëpiak	95%	93%
		Konsumatorët kom & inst me ujëmatës në raport me totalin e konsumatorëve kom & inst	W.2.B.02	% kom & inst	98%	97%
	Ujëmatësit e instaluar	Ujëmatësit e instaluar (shtëpiak)	W.2.B.03	Nr	788	549
		Ujëmatësit e instaluar (kom & inst)	W.2.B.04	Nr	82	0
Ankesat	Ankesat	Ankesat e pranuar (teknike)	W.2.C.01	Nr	2,103	2,284
		Ankesat e pranuar (komerciale)	W.2.C.02	Nr	167	137
<b>Financiar</b>						
Shitjet	Volumet	Volumi i shitjeve për konsumatorët shtëpiak (me ujëmatës)	W.3.A.01	m3	5,727,788	6,225,017
		Volumi i shitjeve për konsumatorët shtëpiak (me ujëmatës) në raport me vlerësimet sipas planit	W.3.A.02	% e vlerësimit sipas planit	82%	85%
		Volumi i shitjeve për konsumatorët shtëpiak (pa ujëmatës)	W.3.A.03	m3	572,186	582,557
		Volumi i shitjeve për konsumatorët shtëpiak (pa ujëmatës) në raport me vlerësimet sipas planit	W.3.A.04	% e vlerësimit sipas planit	202%	616%
		Volumi i shitjeve për konsumatorët kom & inst (me ujëmatës)	W.3.A.05	% e vlerësimit sipas planit	1,353,554	1,842,120
		Volumi i shitjeve për konsumatorët kom & inst (me ujëmatës) në raport me vlerësimet sipas planit	W.3.A.06	% e vlerësimit sipas planit	72%	96%
		Volumi i shitjeve për konsumatorët kom & inst (pa ujëmatës)	W.3.A.07	% e vlerësimit sipas planit	417,478	37,661
		Volumi i shitjeve për konsumatorët kom & inst (pa ujëmatës) në raport me vlerësimet sipas planit	W.3.A.08	% e vlerësimit sipas planit	1,855%	0%
	Vlerat	Vlera e ujit të shitur për konsumatorët shtëpiak	W.3.A.09	EUR	1,743,469	1,938,991
		Vlera e ujit të shitur për konsumatorët shtëpiak në raport me vlerësimet sipas planit	W.3.A.10	% e vlerësimit sipas planit	79%	80%
		Vlera e ujit të shitur për konsumatorët kom & inst	W.3.A.11	EUR	940,161	1,048,965
		Vlera e ujit të shitur për konsumatorët kom & inst në raport me vlerësimet sipas planit	W.3.A.12	% e vlerësimit sipas planit	85%	96%
Kostoja për njësi	Prodhimi	Kostoja operative për njësi të ujit të prodhuar	W.3.B.01	EUR/m3	0.0043	0.0052
		Kostoja totale për njësi të ujit të prodhuar	W.3.B.02	EUR/m3	0.005	0.006
	Kostoja totale	Kostoja për njësi të ujit të shitur	W.3.B.03	EUR/m3	0.207	0.236
		Kostoja për njësi të ujit të shitur dhe të paguar	W.3.B.04	EUR/m3	N/A	N/A
Shpenzimet kapitale	Mirëmbajtja kapitale	Totali i shpenzimeve për mirëmbajtje kapitale	W.3.C.01	EUR	53,541	0
		Totali i shpenzimeve për mirëmbajtje kapitale në raport me planin	W.3.C.02	% e vlerësimit sipas planit	9%	0%
